ASCAP

VEPRIMTARI PRAKTIKE

NË ARSIMIN E MESËM TË ULËT

Klasa VI

Histori

Gjeografi

www.ascap.edu.al

2026

PËRMBAJTJA

I. HYRJE 3

II. QËLLIMI I UDHËZUESIT 3

III. PËRDORUESIT E UDHËZUESIT 4

IV. PARIMET PËR HARTIMIN E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE 5

V. LIDHJA E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE ME REZULTATET E TË NXËNIT 6

VI. VEPRIMTARI PRAKTIKE 7

1. LËNDA: HISTORI 7

2. LËNDA: GJEOGRAFI 59

I. HYRJE

Përditësimi i Kornizës Kurrikulare, i kurrikulave bërthamë dhe i programeve lëndore në arsimin parauniversitar ka sjellë nevojën për rishikimin e mënyrës së planifikimit dhe zhvillimit të procesit mësimor, duke e orientuar atë më qartë drejt të nxënit aktiv dhe përfshirjes së nxënësit në situata reale të të nxënit. Këto përditësime synojnë forcimin e koherencës ndërmjet qëllimeve kurrikulare, rezultateve të të nxënit dhe praktikës mësimore në klasë. Veprimtaritë praktike gjatë orës mësimore përbëjnë një komponent thelbësor për përvetësimin e njohurive, koncepteve dhe aftësive, si dhe për arritjen e rezultateve të të nxënit. Ato u krijojnë nxënësve mundësi konkrete për të zbatuar njohuritë në situata nga jeta e përditshme dhe kontekste reale, për të zhvilluar aftësi praktike, për të ndërtuar njohuri të qëndrueshme dhe për të demonstruar kompetencat e synuara. Në këtë mënyrë, procesi mësimor zhvendoset nga një qasje e fokusuar kryesisht në transmetimin e njohurive drejt një të nxëni aktiv, të mbështetur në veprim, eksplorim, bashkëpunim dhe reflektim. Përditësimet kurrikulare theksojnë gjithashtu përdorimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies, të cilat marrin në konsideratë diversitetin e nxënësve, ritmet e ndryshme të të nxënit dhe ndërlidhjen ndërmjet lëndëve. Në këtë kontekst, veprimtaritë praktike shërbejnë si element lidhës ndërmjet përmbajtjes së programeve lëndore dhe përvojave konkrete të nxënësve, duke ndikuar pozitivisht në motivimin dhe angazhimin e tyre në procesin e të nxënit. Ky udhëzues synon të mbështesë mësuesit në zbatimin e programeve lëndore të përditësuara, duke ofruar shembuj orientues të veprimtarive praktike sipas cikleve arsimore, klasave dhe lëndëve përkatëse. Veprimtaritë e përfshira janë hartuar në përputhje me parimet e programit lëndor dhe synojnë të lehtësojnë planifikimin, organizimin dhe zhvillimin e orëve mësimore që kontribuojnë drejtpërdrejt në zhvillimin e kompetencave dhe përmbushjen e rezultateve të të nxënit.

II. QËLLIMI I UDHËZUESIT

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të shërbejë si një instrument mbështetës për mësuesit në zbatimin sa më cilësor të programeve të përditësuara lëndore, përmes veprimtarive praktike mësimore të orientuara drejt përmbushjes së rezultateve të të nxënit dhe zhvillimit të kompetencave kyçe, si dhe kompetencave specifike të lëndës. Ai synon të lehtësojë kalimin nga dokumenti kurrikular në zbatimin konkret të tij në klasë, duke ofruar shembuj veprimtarish të strukturuara, të shpjeguara qartë dhe të përshtatshme për kontekste të ndryshme mësimore.

Nëpërmjet veprimtarive të propozuara, udhëzuesi mbështet mësuesit në planifikimin dhe organizimin e situatave të të nxënit që nxisin pjesëmarrjen aktive të nxënësve, zhvillojnë mendimin kritik, aftësinë për zgjidhjen e problemeve, bashkëpunimin dhe komunikimin. Këto veprimtari synojnë të krijojnë lidhje funksionale ndërmjet njohurive teorike dhe përvojave konkrete në klasë, duke ndihmuar nxënësit të kuptojnë më mirë konceptet e reja, t'i zbatojnë ato në situata praktike dhe të ndërtojnë njohuri të qëndrueshme.

Udhëzuesi ofron orientime për përzgjedhjen dhe përdorimin e metodave dhe strategjive bashkëkohore të mësimdhënies, duke nxitur përshtatjen e tyre sipas karakteristikave të klasës, ritmeve dhe stileve të ndryshme të të nxënit, si dhe nevojave individuale të nxënësve. Në këtë mënyrë, ai kontribuon në zhvillimin e një mësimdhënieje gjithëpërfshirëse, fleksibile dhe të orientuar drejt nxënësit.

Gjithashtu, udhëzuesi synon të mbështesë koherencën ndërmjet planifikimit mësimor, zbatimit të orës së mësimit dhe vlerësimit të të nxënit, duke ndihmuar mësuesit të lidhin më qartë rezultatet e të nxënit me veprimtaritë konkrete. Kjo qasje ndihmon në rritjen e efektivitetit të procesit mësimor dhe në monitorimin më të mirë të progresit të nxënësve.

Udhëzuesi synon të kontribuojë në unifikimin e praktikave mësimore, në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe në forcimin e rolit të mësuesit si lehtësues i të nxënit dhe udhëheqës pedagogjik në klasë, duke mbështetur zbatimin koherent dhe të qëndrueshëm të kurrikulës dhe programeve të përditësuara.

III. PËRDORUESIT E UDHËZUESIT

Ky udhëzues është hartuar për të mbështetur aktorë të ndryshëm të përfshirë në procesin arsimor, duke synuar zbatimin sa më efektiv të kurrikulës së përditësuar në praktikën e përditshme mësimore. Përdoruesit kryesorë të tij janë mësuesit e arsimit parauniversitar, sipas cikleve arsimore, klasave dhe lëndëve për të cilat janë hartuar veprimtaritë praktike. Për mësuesit, udhëzuesi shërben si material referues për planifikimin ditor, javor dhe afatmesëm të mësimit, duke ofruar shembuj veprimtarish që mund të përzgjidhen, përshtaten ose kombinohen në funksion të rezultateve të të nxënit, nivelit të klasës dhe karakteristikave të nxënësve.

Veprimtaritë e paraqitura nuk kanë karakter detyrues; ato janë orientuese dhe fleksibile, duke i lënë mësuesit hapësirë për përshtatje sipas kontekstit të klasës, ritmeve dhe stileve të ndryshme të të nxënit, si dhe nevojave individuale të nxënësve. Në këtë mënyrë, udhëzuesi lidhet

drejtpërdrejt me procesin e planifikimit mësimor dhe me vlerësimin e të nxënit, duke ndihmuar mësuesit të ndërtojnë situata të të nxënit që mbështesin zhvillimin e kompetencave dhe monitorimin e progresit të nxënësve.

Udhëzuesi është gjithashtu një mbështetje për kryetarët e ekipeve lëndore dhe drejtuesit e rrjeteve profesionale, të cilët mund ta përdorin për të nxitur shkëmbimin e praktikave të mira, për të organizuar diskutime profesionale dhe për të forcuar bashkëpunimin ndërmjet mësuesve. Ai shërben si referencë e përbashkët për reflektim profesional dhe për harmonizimin e praktikave mësimore në nivel shkolle apo rrjeti.

Udhëzuesi përbën një burim të dobishëm edhe për trajnerët duke ofruar shembuj konkretë të praktikave mësimore dhe orientime për zhvillimin profesional të mësuesve. Në një këndvështrim informues, udhëzuesi mund të shërbejë edhe për prindërit, duke i ndihmuar të kuptojnë më qartë mënyrën se si organizohen veprimtaritë praktike dhe si lidhen ato me zhvillimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të nxënësve.

IV. PARIMET PËR HARTIMIN E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE

Hartimi dhe zbatimi i veprimtarive praktike në këtë udhëzues mbështeten në parimet themelore të Kornizës Kurrikulare dhe të programeve të arsimit parauniversitar. Është e rëndësishme të theksohet se ***udhëzuesi nuk trajton zhvillimin e plotë të një ore mësimore***, ***por ofron modele të veprimtarive të veçanta mësimore,*** të cilat mund të integrohen në struktura të ndryshme të orës, në varësi të planifikimit të mësuesit dhe të qëllimeve të përcaktuara në programin lëndor.

Veprimtaritë janë ndërtuar në funksion të arritjes së rezultateve të të nxënit dhe të sigurimit të koherencës ndërmjet programit lëndor, zbatimit në klasë dhe vlerësimit. Ato synojnë të konkretizojnë në praktikë përditësimet kurrikulare, duke mbështetur zhvillimin e nxënësit si individ aktiv, i përgjegjshëm dhe i aftë për të zbatuar njohuritë në situata të ndryshme.

Veprimtaritë praktike udhëhiqen nga këto parime:

- Qasja e bazuar në kompetenca. Çdo veprimtari synon integrimin e njohurive, aftësive dhe qëndrimeve në situata konkrete të të nxënit, duke kontribuar në zhvillimin e kompetencave kyçe dhe të kompetencave specifike të lëndës.
- Nxënësi në qendër të procesit. Veprimtaritë marrin në konsideratë karakteristikat zhvillimore, interesat, ritmet dhe stilet e ndryshme të të nxënit, duke garantuar përfshirje aktive dhe angazhim kuptimplotë.

- Të nxënit aktiv dhe përmes përvojës. Të nxënit realizohet përmes veprimit, eksplorimit, analizës, diskutimit dhe reflektimit, duke nxitur ndërtimin e njohurive të qëndrueshme.
- Lidhja me kontekste reale. Veprimtaritë krijojnë mundësi për zbatimin e njohurive në situata autentike, duke rritur kuptimin dhe rëndësinë e të nxënit.
- Bashkëpunimi dhe komunikimi. Puna në grup, shkëmbimi i ideve dhe ndërveprimi i strukturuar kontribuojnë në zhvillimin e aftësive sociale dhe qytetare.
- Gjithëpërfshirja. Veprimtaritë janë konceptuar në mënyrë që të krijojnë mundësi reale pjesëmarrjeje për të gjithë nxënësit, duke respektuar diversitetin dhe nevojat individuale.
- Fleksibiliteti në zbatim. Veprimtaritë janë orientuese dhe mund të përshtaten sipas kontekstit të klasës, burimeve në dispozicion dhe nivelit të nxënësve, pa cenuar rezultatet e synuara.
- Vlerësimi për të nxënit. Vlerësimi integrohet natyrshëm brenda veprimtarisë, përmes vëzhgimit, pyetjeve orientuese, reflektimit dhe vetëvlerësimit, në funksion të përmirësimit të vazhdueshëm të të nxënit.

V. LIDHJA E VEPRIMTARIVE PRAKTIKE ME REZULTATET E TË NXËNIT

Veprimtaritë praktike të përfshira në këtë udhëzues janë hartuar në lidhje të drejtpërdrejtë me rezultatet e të nxënit të përcaktuara në programet lëndore, sipas tematikave përmbajtësore përkatëse. Kjo do të thotë se veprimtaria nuk paraqitet si një aktivitet i izoluar, por si pjesë funksionale e arritjes së objektivave të përcaktuara në program.

Lidhja ndërmjet rezultateve të të nxënit dhe veprimtarive praktike bazohet në parimin e koherencës kurrikulare. Për secilën tematikë janë identifikuar rezultatet përkatëse dhe janë propozuar veprimtari që u krijojnë nxënësve mundësi reale për t'i demonstruar ato përmes veprimit, analizës, diskutimit, argumentimit apo zgjidhjes së situatave problemore. Në këtë mënyrë, fokusi nuk qëndron vetëm në përvetësimin e njohurive faktike, por edhe në aftësinë për t'i përdorur ato në kontekste të ndryshme dhe për të ndërtuar kuptim të thelluar.

Përmes veprimtarive praktike, nxënësit kanë mundësi të tregojnë se kuptojnë konceptet, të aplikojnë njohuritë në situata të reja, të analizojnë informacionin, të bashkëpunojnë me të tjerët dhe të reflektojnë mbi procesin e të nxënit. Kjo e bën të dukshme arritjen e rezultateve jo vetëm në nivel njohurish, por edhe në nivel aftësish dhe qëndrimesh. Veprimtaritë krijojnë gjithashtu hapësirë për diferencim, duke i mundësuar mësuesit të përshtatë kërkesat sipas nivelit të nxënësve, pa devijuar nga rezultatet e synuara.

Kjo lidhje e qartë ndërmjet rezultateve të të nxënit dhe veprimtarive praktike mbështet mësuesin në planifikimin e qëndrueshëm të procesit mësimor dhe në përzgjedhjen e metodave të përshtatshme. Ajo lehtëson gjithashtu vlerësimin e progresit të nxënësve, pasi kriteret e vlerësimit mund të ndërtohen drejtpërdrejt mbi rezultatet që synohen të arrihen përmes veprimtarisë.

Udhëzuesi ofron një kornizë praktike që garanton koherencë ndërmjet planifikimit, zbatimit dhe vlerësimit, duke e bërë procesin mësimor më të strukturuar, më transparent dhe më të orientuar drejt arritjeve konkrete të nxënësve.

VI. VEPRIMTARI PRAKTIKE

1. LËNDA: HISTORI

Veprimtaritë praktike në lëndën e historisë përfaqësojnë një qasje metodologjike aktive dhe bashkëkohore, e cila synon ta vendosë nxënësin në qendër të procesit të të nxënit, duke e angazhuar atë në kërkim, analizë, interpretim dhe reflektim mbi ngjarjet, proceset dhe dukuritë historike. Në këtë qasje, historia nuk trajtohet vetëm si përvetësim i fakteve dhe i datave historike, por si një proces përmes të cilit nxënësi zhvillon të menduarin kritik, aftësinë për të interpretuar burime historike dhe për të kuptuar lidhjen ndërmjet së kaluarës dhe realitetit të sotëm.

Veprimtaritë praktike ndërtohen mbi situata konkrete, materiale historike, harta, dokumente, ilustrime, objekte kulturore, kronologji, dëshmi historike dhe kontekste nga jeta reale, duke i përfshirë nxënësit në punë individuale dhe në grup, diskutime, kërkime të thjeshta historike, analiza burimesh, lojëra me role (role-play), projekte, prezantime dhe interpretim të informacionit historik. Kjo metodologji ndihmon nxënësit të kuptojnë më mirë zhvillimin e qytetërimeve, mënyrën e jetesës së njerëzve në periudha të ndryshme historike, si dhe ndikimin që ngjarjet historike kanë pasur në zhvillimin e shoqërisë njerëzore.

Përmes këtyre veprimtarive zhvillohen kompetenca të rëndësishme të fushës së historisë, si interpretimi dhe përdorimi i burimeve historike, mendimi kronologjik, analiza e marrëdhënieve shkak-pasojë, komunikimi historik, krahasimi i periudhave dhe qytetërimeve, si dhe aftësia për të argumentuar dhe për të ndërtuar qëndrime mbi çështje historike dhe qytetare. Veprimtaritë praktike kontribuojnë gjithashtu në zhvillimin e aftësive bashkëpunuese, vetëvlerësimit, respektit për trashëgiminë kulturore dhe edukimit qytetar.

Këto veprimtari lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e të nxënit (RN), pasi çdo detyrë praktike synon demonstrimin konkret të njohurive, aftësive dhe qëndrimeve që nxënësi duhet të zhvillojë gjatë studimit të historisë. Përmes tyre, mësuesi mund të realizojë edhe vlerësim të vazhdueshëm të performancës së nxënësit, duke vëzhguar mënyrën e interpretimit të informacionit, analizës së burimeve, argumentimit dhe komunikimit të ideve historike. Më poshtë paraqiten disa modele të veprimtarive praktike për përmbushjen e rezultateve të të nxënit në lëndën e historisë për klasën e gjashtë. Mësuesi mund t'i përshtatë dhe t'i pasurojë ato sipas nivelit, interesave dhe nevojave të nxënësve, si dhe sipas kontekstit të klasës, mjedisit lokal dhe situatave reale që lidhen me përmbajtjen historike.

Tabela 1. Shembuj veprimtarish mësimore për përmbushjen e RN në tematikën "Qytetërimet e hershme në Antikitet, mijëvjeçarët IV – II para erës sonë"

Rezultatet e të nxënit	*Veprimtari mësimore*
6RN(QhA-M)1.2.3: Nxënësi tregon tiparet e organizimit shtetëror në Mesopotami. 6RN(QhA-M)1.2.4:Nxënësi tregon rolin e ligjeve të Hamurabit në zhvillimet	**Situata e të nxënit** Mësuesi nis veprimtarinë duke paraqitur para nxënësve një situatë imagjinare: *"Imagjinoni se jeni banorë të një qyteti në Mesopotami rreth 4000 vjet më parë. Qyteti juaj po rritet, njerëzit janë shtuar, ka tregti, bujqësi dhe konflikte për tokën dhe ujin. Çfarë rregullash dhe institucionesh do t'ju duheshin për të organizuar jetën në qytet?"* Mësuesi shfaq harta, pamje ose ilustrime të qyteteve të lashta mesopotamike, si Babilonia dhe figura të mbretërve, tempujve, kanaleve ujitëse dhe ligjeve të Hamurabit.

ekonomike, shoqërore e politike në Mesopotami.



Nxënësit vëzhgojnë hartën e Mesopotamisë dhe identifikojnë lumenjtë Tigër dhe Eufrat, qytet-shtetet kryesore dhe zonat ku u zhvilluan qytetërimet e hershme. Përmes hartës, nxënësit nxiten të japin mendimet e tyre rreth mënyrës se si mund të funksiononte shteti në Mesopotami dhe pse qytetërimet u zhvilluan pranë lumenjve.

Mësuesi paraqet disa ilustrime të Mesopotamisë.

Analiza dhe interpretimi i situatës

Mësuesi paraqet ilustrimet e mëposhtme:

	Nxënësit diskutojnë fillimisht për pyetje të tilla, si: - Pse njerëzit kishin nevojë për një shtet? - Kush mund të merrte vendime në qytetet mesopotamike? - Si mund të ruheshin rendi dhe ligjet? - Pse lumenjtë kishin rëndësi për zhvillimin e qytetërimeve? Mësuesi udhëheq diskutimin për të evidentuar elementet kryesore të organizimit shtetëror në Mesopotami: mbreti, ligjet, administrata, ushtria, roli i priftërinjve dhe organizimi i qytet-shteteve. Nxënësit analizojnë gjithashtu ilustrimet dhe pamjet historike për të kuptuar lidhjen ndërmjet pushtetit politik, jetës fetare dhe organizimit ekonomik. **Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën** Mësuesi ***organizon klasën në grupe pune.*** Çdo grup merr një detyrë të veçantë për të analizuar një aspekt të organizimit shtetëror në Mesopotami. ▪ Grupi 1 shpjegon rolin e mbretit në Mesopotami dhe diskuton për pushtetin, detyrat dhe mënyrën si drejtohej shteti. ▪ Grupi 2 përshkruan ligjet e Hamurabit dhe diskuton pse shoqëria kishte nevojë për ligje dhe dënime. ▪ Grupi 3 identifikon rolin e tempujve dhe priftërinjve në jetën politike dhe shoqërore të Mesopotamisë. ▪ Grupi 4 përshkruan organizimin e qytet-shteteve dhe diskuton si bashkëpunonin ose konfliktoheshin ato me njëra-tjetrën. Gjatë punës, nxënësit përdorin tekstin, harta, ilustrime, pamje historike ose materiale të tjera burimore për të mbledhur informacion dhe për të ndërtuar argumentet e tyre. Ata analizojnë materialet vizuale për të identifikuar elementet kryesore të organizimit shtetëror, rolin e lumenjve në zhvillimin ekonomik dhe rëndësinë e ligjeve për ruajtjen e rendit

shoqëror. Nxënësit krahasojnë idetë dhe diskutojnë mbi rëndësinë e organizimit shtetëror për jetën e qytetërimeve të hershme. Secili grup prezanton gjetjet përpara klasës.

Mësuesi nxit mendimin kritik me pyetje të tilla, si:

- Pse mbreti kishte kaq shumë pushtet në Mesopotami?
- Çfarë do të ndodhte nëse nuk do të kishte ligje?
- A mendoni se ligjet e Hamurabit ishin të drejta për të gjithë? Pse?
- Cilat ngjashmëri dhe ndryshime vini re midis shtetit në Mesopotami dhe shtetit sot?
- Si ndikuan lumenjtë në zhvillimin e qytetërimeve mesopotamike?

Në fazën përmbyllëse nxënësit ndërtojnë së bashku, linjën e kohës për zhvillimin e Mesopotamisë dhe ***një skemë ose tabelë*** ku paraqiten tiparet kryesore të organizimit shtetëror në Mesopotami, si modelet e paraqitura më poshtë:

Skemë: Tiparet kryesore të organizimit shtetëror në Mesopotami

Elementi i organizimit shtetëror	Tiparet kryesore
Mbreti	Drejtonte shtetin, ushtrinë dhe administratën; konsiderohej përfaqësues i perëndive në Tokë.
Ligjet	Rregullonin jetën shoqërore dhe ruanin rendin; më i njohuri ishte Kodi i Hamurabit.
Tempulli dhe priftërinjtë	Kishin rol fetar, ekonomik dhe politik; organizonin ceremonitë dhe administronin pasuritë e tempullit.
Administrata	Mblidhte taksat, organizonte punët publike dhe kontrollonte territorin.
Ushtria	Mbronte qytetin-shtet dhe merrte pjesë në luftëra për zgjerim territori ose mbrojtje.
Kanalet ujitëse	Siguronin ujë për bujqësinë; organizimi i tyre kërkonte bashkëpunim dhe drejtim shtetëror.
Qytet-shtetet	Çdo qytet kishte sundimtarin, ligjet dhe ushtrinë e vet (Ur, Uruk, Babiloni etj.).
Shkrimi	Përdorej për administrimin e shtetit, tregtinë dhe regjistrimin e ligjeve.

	Linja e kohës – Mesopotamia  **Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve** Në fund të veprimtarisë, secili nxënës shkruan një reflektim të shkurtër mbi pyetjen: *"Cili element i organizimit shtetëror në Mesopotami mendoni se ishte më i rëndësishëm për funksionimin e shoqërisë dhe pse?"* Kjo veprimtari i ndihmon nxënësit të kuptojnë mënyrën e organizimit të shteteve të para në histori, të zhvillojnë aftësinë për të interpretuar informacionin historik, për të argumentuar dhe për të lidhur të kaluarën me mënyrën si funksionojnë shtetet sot. **Kompetencat që zhvillon nxënësi** *Kompetenca historike:* - përdor dhe interpreton informacionin historik nga burime të ndryshme; - shpjegon organizimin politik dhe shoqëror të qytetërimeve të hershme; - analizon marrëdhënien shkak-pasojë në zhvillimin e shteteve të para; - krahason organizimin shtetëror të Mesopotamisë me forma të organizimit shtetëror në periudha të tjera ose në ditët e sotme; - ndërton dhe interpreton linjën e kohës për zhvillimin e qytetërimeve të hershme; - përdor harta, skema dhe materiale vizuale për të kuptuar zhvillimet historike;

	- zhvillon mendimin kritik dhe argumentimin historik. *Kompetenca kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës:* - kompetenca e komunikimit, përmes diskutimeve, argumentimit dhe prezantimit të ideve; - kompetenca personale, përmes reflektimit, bashkëpunimit dhe vetëvlerësimit; - kompetenca qytetare, përmes kuptimit të rolit të ligjeve, organizimit shtetëror dhe bashkëjetesës në shoqëri; - kompetenca për sipërmarrjen, përmes bashkëpunimit në grup, organizimit të punës dhe marrjes së përgjegjësive gjatë realizimit të detyrave; - kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, përmes njohjes dhe vlerësimit të trashëgimisë historike dhe kulturore të qytetërimeve të lashta; - kompetenca digjitale, në rastet kur përdoren materiale digjitale, harta, ilustrime ose prezantime elektronike.

***Tabela 2. Shembuj veprimtarish mësimore për përmbushjen e RN në tematikën* "Qytetërimet klasike në Mesdhe, shek. VIII para erës sonë – shek. V të erës sonë"**

Rezultatet e të nxënit	***Veprimtari mësimore***
6RN(QkM-QG)2.2.3: *Nxënësi vlerëson rolin e demokracisë antike në zhvillimin e qytetërimin grek dhe qytetërimeve të mëvonshme.*	**Situata e të nxënit:** Mësuesi nis veprimtarinë duke paraqitur një situatë problemore*: "Imagjinoni se klasa juaj duhet të marrë një vendim shumë të rëndësishëm, por vetëm një grup i vogël nxënësish ka të drejtë të flasë dhe të vendosë. A do t'ju dukej kjo e drejtë? Si mendoni se duhet të merren vendimet që prekin të gjithë?"* Nxënësit japin mendimet e tyre. Më pas, mësuesi paraqet pamje, ilustrime ose skema të Athinës antike, Agorasë, kuvendit popullor dhe qytetarëve athinas gjatë diskutimeve publike.

	Greqia e Lashtë dhe qytetet kryesore Mësuesi shpjegon shkurt se në Athinën antike lindi demokracia, ku qytetarët merrnin pjesë në vendimmarrje. **Analiza dhe interpretimi i situatës** Nxënësit vëzhgojnë ilustrimet dhe diskutojnë pyetjet: - Çfarë kuptoni me fjalën "demokraci"? - Kush mendoni se merrte pjesë në vendimmarrje në Athinën antike?

- A kishin të gjithë banorët të drejta të barabarta?
- Pse demokracia ishte e rëndësishme për qytetërimin grek?

Mësuesi udhëheq diskutimin për të evidentuar tiparet kryesore të demokracisë athinase: pjesëmarrjen e qytetarëve, votimin, diskutimin publik dhe rolin e kuvendit popullor.

Nxënësit analizojnë gjithashtu dallimet midis demokracisë antike dhe demokracisë së sotme.

Athina në Greqinë e Lashtë



Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

Mësuesi organizon klasën në grupe pune. Çdo grup merr një detyrë të veçantë.

- Grupi 1 identifikon tiparet kryesore të demokracisë në Athinën antike.
- Grupi 2 analizon të drejtat dhe kufizimet e qytetarëve në demokracinë athinase.
- Grupi 3 krahason demokracinë antike me demokracinë e sotme duke përdorur Diagramin e Venit.
- Grupi 4 diskuton ndikimin që pati demokracia greke në qytetërimet dhe shtetet e mëvonshme.

Gjatë punës, nxënësit përdorin tekstin, ilustrime historike, skema dhe materiale burimore për të mbledhur informacion dhe për të ndërtuar argumentet e tyre.

Mësuesi paraqet modelin e mëposhtëm të "Diagramit të Venit" për krahasimin e demokracisë antike me demokracinë e sotme

Diagrami i Venit.



Më pas, mësuesi organizon teknikën **"Di – Dua të di – Mësova" (DDL/M)**. Nxënësit plotësojnë tabelën e mëposhtme:

Di	Dua të di	Mësova
Çfarë dimë për demokracinë?	*Çfarë duam të dimë për demokracinë në Athinën antike?*	*Çfarë mësuam nga veprimtaria?*

Secili grup prezanton gjetjet përpara klasës. Nxënësit argumentojnë mendimet e tyre dhe krahasojnë përfundimet e grupeve të tjera. Mësuesi nxit mendimin kritik me pyetje të tilla, si:

- A ishte demokracia athinase demokratike për të gjithë?
- Pse demokracia konsiderohet një arritje e rëndësishme e qytetërimit grek?
- Çfarë elementesh të demokracisë antike përdoren edhe sot?
- Cilat janë ndryshimet kryesore midis demokracisë së atëhershme dhe asaj moderne?

Në fazën përmbyllëse, nxënësit ndërtojnë së bashku një skemë ku paraqiten tiparet kryesore të demokracisë antike dhe ndikimi i saj në qytetërimet e mëvonshme.

Skemë: Roli i demokracisë antike

Elementi	Roli në qytetërimin grek dhe më vonë
Kuvendi popullor	Qytetarët merrnin pjesë në vendimmarrje
Votimi	Ndihmonte në zgjedhjen dhe miratimin e vendimeve
Diskutimi publik	Nxiste debatin dhe shkëmbimin e ideve
Ligjet	Rregullonin jetën politike dhe shoqërore
Ndikimi historik	Frymëzoi demokracitë moderne

Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve

Në fund të veprimtarisë, secili nxënës shkruan një reflektim të shkurtër mbi pyetjen: *"Pse mendoni se demokracia e Athinës konsiderohet një nga arritjet më të rëndësishme të qytetërimit grek?"*

Kjo veprimtari i ndihmon nxënësit të kuptojnë rëndësinë historike të demokracisë antike, të zhvillojnë mendimin kritik dhe aftësinë për të krahasuar format e organizimit politik në periudha të ndryshme historike.

Kompetencat që zhvillon nxënësi

Kompetenca historike:

	- përdor dhe interpreton informacionin historik nga burime të ndryshme; - shpjegon tiparet kryesore të demokracisë në Athinën antike; - analizon ndikimin e demokracisë greke në zhvillimin e qytetërimeve të mëvonshme; - krahason demokracinë antike me format moderne të demokracisë; - përdor Diagramin e Venit dhe organizues grafikë për të analizuar informacionin historik; - zhvillon mendimin kritik dhe argumentimin historik. ***Kompetenca kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës:*** - kompetenca e komunikimit, përmes diskutimeve, debatit dhe prezantimit të ideve; - kompetenca personale, përmes reflektimit, bashkëpunimit dhe vetëvlerësimit; - kompetenca qytetare, përmes kuptimit të demokracisë, të drejtave dhe pjesëmarrjes qytetare; - kompetenca për sipërmarrjen, përmes organizimit të punës në grup dhe marrjes së përgjegjësive; - kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, përmes vlerësimit të trashëgimisë politike dhe kulturore të qytetërimit grek; - kompetenca digjitale, në rastet kur përdoren harta digjitale, ilustrime, materiale audiovizive ose prezantime elektronike për analizimin e demokracisë në Athinën antike.

Tabela 3. Shembuj veprimtarish mësimore për përmbushjen e RN në tematikën "Qytetërimet klasike në Mesdhe, shek. VIII para erës sonë – shek. V të erës sonë"

Rezultatet e të nxënit	*Veprimtari mësimore*
6RN(QkM-QR)2.3.2: Nxënësi përshkruan	**Situata e të nxënit:** Mësuesi nis veprimtarinë duke paraqitur një situatë problemore: *"Imagjinoni se një qytet ndryshon mënyrën e qeverisjes disa herë gjatë historisë së tij: fillimisht drejtohet nga mbretër, më pas nga qytetarë*

evolucionin politik të Romës.	*të zgjedhur dhe në fund nga një perandor me pushtet të madh. Si mendoni se ndikojnë këto ndryshime në jetën e njerëzve?"* Nxënësit japin mendimet e tyre spontanisht. Më pas, mësuesi paraqet harta, ilustrime ose skema të Romës së lashtë, Senatit romak, figurave të mbretërve, republikës dhe perandorëve romakë. *Roma e lashtë*

Republika dhe konfliktet politike

Triumvirati: Pompey, Crassus, and Julius Caesar

Augusti dhe fillimi i Perandorisë

Harta e Perandorisë në kulmin e saj (117 e.s.)

	Nxënësit vëzhgojnë materialet dhe diskutojnë mbi mënyrat e ndryshme të organizimit politik në Romë. **Analiza dhe interpretimi i situatës** Nxënësit diskutojnë për pyetjet: - Çfarë kuptoni me fjalën "monarki", "republikë" dhe "perandori"? - Kush mendoni se kishte pushtetin në secilën periudhë? - Pse Roma ndryshoi mënyrën e qeverisjes? - Si ndikuan këto ndryshime në fuqizimin e Romës? Mësuesi udhëheq diskutimin për të evidentuar fazat kryesore të evolucionit politik të Romës: *monarkia, republika dhe perandoria.* Nxënësit analizojnë gjithashtu rolin e Senatit, ushtrisë dhe perandorëve në jetën politike romake. **Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën** Mësuesi organizon klasën në grupe pune dhe realizon një lojë me role/simulim historik me temë: ***"Roma ndryshon mënyrën e qeverisjes."*** Çdo grup përfaqëson një periudhë të ndryshme të evolucionit politik të Romës. - **Grupi 1 – Monarkia romake** Nxënësit interpretojnë mbretin, këshilltarët dhe qytetarët. Ata paraqesin mënyrën si drejtohej Roma gjatë monarkisë dhe rolin e mbretit në marrjen e vendimeve. - **Grupi 2 – Republika romake** Nxënësit interpretojnë senatorët, konsujt dhe qytetarët romakë. Ata simulojnë një mbledhje të Senatit ku diskutohet një vendim për qytetin.

- **Grupi 3 – Perandoria romake**

  Nxënësit interpretojnë perandorin, ushtrinë dhe administratorët. Ata paraqesin mënyrën si përqendrohej pushteti te perandori dhe si kontrollohej territori i gjerë romak.

- **Grupi 4 – Historianët**

  Ky grup vëzhgon simulimet dhe evidenton ndryshimet kryesore ndërmjet monarkisë, republikës dhe perandorisë.

Gjatë simulimit, nxënësit përdorin ilustrime, skema, harta ose simbole historike për të paraqitur periudhën e tyre. Ata diskutojnë, argumentojnë dhe mbrojnë rolin që kanë në sistemin politik të Romës.

Pas lojës me role, mësuesi organizon një diskutim reflektues me pyetje të tilla, si:

- Në cilën periudhë mendoni se qytetarët kishin më shumë rol?
- Pse Roma kaloi nga republika në perandori?
- Cilat ishin avantazhet dhe dobësitë e secilës formë qeverisjeje?
- Si ndikoi ushtria në fuqizimin e Perandorisë Romake?

Më pas, mësuesi paraqet modelin e mëposhtëm të linjës së kohës për evolucionin politik të Romës:



Nxënësit plotësojnë më pas një tabelë krahasuese për të evidentuar ndryshimet ndërmjet tri periudhave politike të Romës.

Monarkia	Republika	Perandoria
Mbreti drejton shtetin	Senati dhe konsujt marrin vendime	Perandori ka pushtetin kryesor
Pushteti trashëgohet	Zgjedhje dhe institucione	Ushtria mbështet perandorin
Qytetarët kanë pak rol	Rritet roli i qytetarëve	Pushteti përqendrohet te një person

Më pas, mësuesi organizon teknikën **"Di – Dua të di – Mësova" (DDL/M)**. Nxënësit plotësojnë tabelën:

Di	Dua të di	Mësova
Çfarë dimë për Romën?	Çfarë duam të dimë për qeverisjen e saj?	Çfarë mësuam nga veprimtaria?

Secili grup prezanton gjetjet përpara klasës. Nxënësit argumentojnë mendimet e tyre dhe krahasojnë përfundimet e grupeve të tjera.

Në fazën përmbyllëse, nxënësit ndërtojnë së bashku një hartë konceptuale ku paraqiten fazat kryesore të evolucionit politik të Romës dhe tiparet e secilës periudhë.

Skemë: Evolucioni politik i Romës





Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve

Në fund të veprimtarisë, nxënësit ndërtojnë një tabelë krahasuese ku evidentojnë tiparet kryesore të Monarkisë, Republikës dhe Perandorisë Romake, duke analizuar ndryshimet në organizimin politik dhe drejtimin e shtetit.

Tabelë krahasuese: Monarkia – Republika – Perandoria Romake

Tipari	**Monarkia Romake**	**Republika Romake**	**Perandoria Romake**
Periudha	**753 p.e.s. – 509 p.e.s.**	**509 p.e.s. – 27 p.e.s.**	**27 p.e.s. – 476 e.s.**
Kreu i shtetit	Një mbret i vetëm (Rex), që sundonte përjetë	Dy konsuj të zgjedhur për mandate njëvjeçare.	Një perandor, që sundonte me pushtet të plotë.
Mënyra e qeverisjes	Pushteti përqendrohej te mbreti	Vendimet merreshin nga Senati dhe qytetarët	Pushteti përqendrohej te perandori
Trashëgimia e pushtetit	Zakonisht trashëgohej ose miratohej nga Senati/populli.	Zgjidhej nga qytetarët përmes votimeve vjetore.	Pasardhësit zgjidheshin nga perandori ose merrnin pushtetin me mbështetjen e ushtrisë.

	Organet drejtuese	Mbreti dhe Senati këshillimor të përbërë nga pleq fisnikë.	Senati, konsujt dhe kuvendet qytetare që votonin ligjet dhe zgjedhjet.	Perandori dhe administrata perandorake, të cilët ia kufizuan Senatit pjesën më të madhe të pushtetit real.
	Roli i qytetarëve	Shumë i kufizuar	Më i madh në jetën politike	I kufizuar nga pushteti i perandorit
	Ushtria	Drejtohej nga mbreti Qytetarët organizoheshin sipas klasave shoqërore dhe drejtoheshin nga mbreti.	Qytetarët shërbenin në ushtri Qytetarët-ushtarë duhej të shërbenin për të marrë pjesë në jetën politike.	Ushtri profesioniste e paguar nga shteti, besnike ndaj perandorit.
	Territori	Qyteti i Romës dhe zonat përreth në Itali.	Zgjerim i madh në Mesdhe përmes luftërave.	Perandori shumë e gjerë Arriti shtrirjen më të madhe territoriale dhe u përqendrua në mbrojtjen e kufijve.
	Fundi i periudhës	Rrëzimi i mbretit të fundit U rrëzua për shkak të sundimit tiranik të mbretit të fundit, Tarkuin Superbi.	Luftëra civile dhe kriza politike. U përfshi në luftëra civile dhe luftë për pushtet ndërmjet gjeneralëve.	Rënia e Perandorisë Romake Perëndimore Ra për shkak të krizave të brendshme, sulmeve barbare dhe dobësimit ekonomik.
	Kjo veprimtari i ndihmon nxënësit të kuptojnë evolucionin politik të Romës, të analizojnë ndryshimet historike dhe të zhvillojnë aftësinë për të krahasuar forma të ndryshme qeverisjeje. ***Kompetencat që zhvillon nxënësi*** *Kompetenca historike:* - përdor dhe interpreton informacionin historik nga burime të ndryshme; - përshkruan evolucionin politik të Romës;			

	- analizon ndryshimet ndërmjet monarkisë, republikës dhe perandorisë; - ndërton dhe interpreton linjën e kohës për zhvillimet politike të Romës; - përdor harta konceptuale, tabela krahasuese dhe simulime historike për analizimin e informacionit historik; - zhvillon mendimin kritik dhe argumentimin historik. *Kompetenca kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës:* - kompetenca e komunikimit , përmes diskutimeve, debatit, lojës me role dhe prezantimit të ideve; - kompetenca personale, përmes reflektimit, bashkëpunimit dhe vetëvlerësimit; - kompetenca qytetare, përmes kuptimit të formave të organizimit politik dhe rolit të institucioneve; - kompetenca për sipërmarrjen, përmes organizimit të punës në grup dhe marrjes së përgjegjësive; - kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, përmes vlerësimit të trashëgimisë politike dhe historike të qytetërimit romak; - kompetenca digjitale, në rastet kur përdoren harta digjitale, ilustrime, materiale audiovizive ose prezantime elektronike.

Tabela 4. Shembuj veprimtarish mësimore për përmbushjen e RN në tematikën "Qytetërimet në mesjetën e hershme, shek. V – X."

Rezultatet e të nxënit	*Veprimtari mësimore*
6RN(Mh-PB)3.2.1: *Nxënësi përshkruan tiparet e organizimit shtetëror dhe shoqëror në qytetërimin bizantin.*	**Situata e të nxënit** Mësuesi nis veprimtarinë duke paraqitur një situatë problemore: *"Imagjinoni se drejtoni një perandori shumë të madhe, ku jetojnë popuj të ndryshëm, fliten gjuhë të ndryshme dhe ka shumë territore për t'u administruar. Çfarë institucionesh dhe rregullash do t'ju duheshin për ta mbajtur shtetin të bashkuar?"* Nxënësit japin spontanisht mendimet e tyre. Më pas, mësuesi paraqet harta, ilustrime ose skema të Perandorisë Bizantine, Kostandinopojës, perandorit bizantin, administratës shtetërore dhe jetës shoqërore në Bizant. Nxënësit vëzhgojnë materialet dhe diskutojnë mbi mënyrën si organizohej shteti bizantin. *Harta e Perandorisë Bizantine* *Një mozaik i shekullit VI të erës sonë që paraqet perandorin Justinian dhe oborrin e tij në Bazilikën e San Vitales në Ravena*

Pamje e rikonstruktuar e Kostandinopojës nga shekulli IV–XIII i erës sonë

Shën Sofia - kryevepra arkitekturore e Perandorisë Bizantine

Analiza dhe interpretimi i situatës

Nxënësit diskutojnë për pyetje të tilla, si:

- Çfarë kuptoni me fjalën “perandori”?
- Pse Perandoria Bizantine kishte nevojë për një administratë të fortë?
- Kush mendoni se kishte pushtetin në Bizant?
- Si ishte e organizuar shoqëria bizantine?

Mësuesi udhëheq diskutimin për të evidentuar tiparet kryesore të organizimit shtetëror dhe shoqëror në Bizant: rolin e perandorit, administratën, ushtrinë, kishën dhe shtresat shoqërore. Nxënësit analizojnë gjithashtu lidhjen ndërmjet pushtetit politik dhe fesë në qytetërimin bizantin.

Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën/Veprimi në situatë

	Mësuesi organizon veprimtarinë duke përdorur teknikën **"Karrigia e historianit"**. Në klasë vendoset një karrige simbolike, e cila përfaqëson "historianin bizantin". Nxënësit marrin role të ndryshme dhe përpiqen të përshkruajnë organizimin shtetëror dhe shoqëror të Perandorisë Bizantine nga këndvështrime të ndryshme historike. Mësuesi ndan klasën në grupe pune: - **Grupi 1 – Perandori dhe administrata** Nxënësit analizojnë pushtetin e perandorit dhe mënyrën si organizohej administrata bizantine. - **Grupi 2 – Kisha dhe feja** Nxënësit analizojnë rolin e kishës dhe ndikimin e saj në jetën politike dhe shoqërore. - **Grupi 3 – Ushtria dhe mbrojtja** Nxënësit përshkruajnë organizimin ushtarak dhe rolin e ushtrisë në mbrojtjen e Perandorisë. - **Grupi 4 – Shoqëria bizantine** Nxënësit analizojnë shtresat shoqërore dhe jetën e përditshme të fisnikëve, tregtarëve, zejtarëve dhe fshatarëve. Pas përgatitjes, nga çdo grup një nxënës ulet në "Karrigen e historianit" dhe paraqet informacionin historik sikur të ishte një historian që shpjegon jetën në Bizant. Nxënësit e tjerë bëjnë pyetje, kërkojnë sqarime dhe diskutojnë mbi përgjigjet. Mësuesi nxit mendimin kritik me pyetje të tilla, si: - Pse perandori kishte pushtet kaq të madh? - Si ndikonte feja në jetën politike të Bizantit? - Pse administrata bizantine ishte e rëndësishme për mbijetesën e Perandorisë? - Cilat shtresa shoqërore kishin më shumë ndikim në Bizant?

	Në fazën përmbyllëse, nxënësit ndërtojnë një tabelë ose hartë konceptuale ku evidentojnë tiparet kryesore të organizimit shtetëror dhe shoqëror në qytetërimin bizantin. Mësuesi paraqet modelin e mëposhtëm:  Më pas, mësuesi organizon teknikën **"Di – Dua të di – Mësova"**. Nxënësit plotësojnë tabelën: **Di** | **Dua të di** | **Mësova** Çfarë dimë për Bizantin? | Çfarë duam të dimë për organizimin e tij? | Çfarë mësuam nga veprimtaria? Secili grup prezanton gjetjet përpara klasës. Nxënësit argumentojnë mendimet e tyre dhe krahasojnë përfundimet e grupeve të tjera.

Mësuesi paraqet linjën kohore të Bizantit.

Bizanti - Linja kohore

Data/Periudha	Ngjarja kryesore
rreth vitit 657 p.e.s.	Kolonë grekë nga Megara themelojnë Bizantin në Bosfor.
196 e.s.	Qyteti dëmtohet gjatë luftërave civile romake dhe më vonë rindërtohet nga Septim Severi.
324–330 e.s.	Konstandini I zgjedh Bizantin si kryeqytetin e ri perandorak.
330 e.s.	Qyteti emërtohet zyrtarisht Kostandinopojë.
395 e.s.	Kostandinopoja bëhet kryeqyteti i Perandorisë Romake të Lindjes.
527–565 e.s.	Nën Justinianin I, Perandoria arrin kulmin e saj dhe ndërtohet Shën Sofia (Hagia Sophia).
532 e.s.	Revolta e Nikës trondit Kostandinopojën.
Shekulli VII	Perandoria humbet territore të mëdha lindore gjatë zgjerimit islamik.
Shekujt VIII–IX	Ikonoklazma shkakton përçarje për shkak të debateve mbi ikonat fetare.

867–1056 e.s.	Dinastia Maqedonase sjell ringjallje kulturore dhe ushtarake.
1054 e.s.	Skizma e Madhe thellon ndarjen ndërmjet Kishës Ortodokse Lindore dhe Kishës Katolike Romake.
1071 e.s.	Humbja në betejën e Manzikertit sjell humbje të mëdha territoriale në Anadoll.
1204 e.s.	Kryqëzata e Katërt pushton dhe plaçkit Kostandinopojën.
1261 e.s.	Bizantinët rimarrin Kostandinopojën.
1453 e.s.	Osmanët pushtojnë Kostandinopojën, duke shënuar fundin e Perandorisë Bizantine.

Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve

Në fund të veprimtarisë, nxënësit ndërtojnë një tabelë ku evidentojnë tiparet kryesore të organizimit shtetëror dhe shoqëror në qytetërimin bizantin.

Organizimi shtetëror	Organizimi shoqëror
Perandori kishte pushtetin kryesor	Shoqëria ndahej në shtresa
Administratë e organizuar	Fisnikë, tregtarë, zejtarë, fshatarë
Ushtri e fuqishme	Ndikim i madh i kishës në jetën shoqërore
Ligje dhe institucione	Jetë urbane dhe tregti e zhvilluar

Kjo veprimtari i ndihmon nxënësit të kuptojnë tiparet kryesore të organizimit shtetëror dhe shoqëror në Bizant, të interpretojnë informacionin historik dhe të zhvillojnë mendimin kritik.

Kompetencat që zhvillon nxënësi

Kompetenca historike:

	- përdor dhe interpreton informacionin historik nga burime të ndryshme; - përshkruan organizimin shtetëror dhe shoqëror në qytetërimin bizantin; - analizon rolin e perandorit, kishës dhe administratës në Bizant; - përdor harta, skema, tabela dhe organizues grafikë për analizimin e informacionit historik; - krahason elemente të organizimit bizantin me shtete të tjera historike; - zhvillon mendimin kritik dhe argumentimin historik. *Kompetenca kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës:* - kompetenca e komunikimit, përmes diskutimeve, prezantimit të ideve dhe argumentimit; - kompetenca personale, përmes bashkëpunimit, reflektimit dhe vetëvlerësimit; - kompetenca qytetare, përmes kuptimit të organizimit shtetëror dhe rolit të institucioneve; - kompetenca për sipërmarrjen, përmes organizimit të punës në grup dhe marrjes së përgjegjësive; - kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, përmes njohjes dhe vlerësimit të trashëgimisë bizantine; - kompetenca digjitale, në rastet kur përdoren harta digjitale, ilustrime, materiale audiovizive ose prezantime elektronike.
6RN(Mh-QA&E)3.3.3: *Nxënësi vlerëson arritjet e qytetërimit arab në art, kulturë dhe shkencë dhe ndikimin e tij në Evropë, si dhe njeh dhe*	**Situata e të nxënit** Mësuesi nis veprimtarinë duke paraqitur një situatë problemore: *"Imagjinoni një botë pa libra shkencorë, pa algjebër, pa spitale moderne apo pa shumë njohuri që përdorim sot. Si mendoni, kush kontribuoi në ruajtjen dhe zhvillimin e dijes gjatë Mesjetës?"* Nxënësit japin mendimet e tyre. Më pas, mësuesi paraqet harta, ilustrime ose pamje të qyteteve arabe si Bagdadi, Damasku dhe Kordoba, figura të shkencëtarëve dhe dijetarëve arabë, dorëshkrime, observatorë astronomikë,

vlerëson disa nga figurat historike që i përkasin kësaj tematike, si: Justiniani, Muhamedi, Omar Khajami, Avicena etj.	biblioteka, xhami dhe objekte arti islam. Nxënësit vëzhgojnë materialet dhe diskutojnë mbi zhvillimin e qytetërimit arab. **Analiza dhe interpretimi i situatës** Nxënësit diskutojnë për pyetje: - Çfarë kuptoni me fjalën "qytetërim"? - Pse qytetërimi arab konsiderohet i zhvilluar për kohën? - Në cilat fusha mendoni se kontribuuan dijetarët arabë? - Si ndikoi qytetërimi arab në zhvillimin e Evropës? Mësuesi udhëheq diskutimin për të evidentuar arritjet kryesore të qytetërimit arab në: *shkencë; matematikë; mjekësi; astronomi; art dhe arkitekturë; letërsi dhe kulturë.* Nxënësit analizojnë gjithashtu rolin e figurave historike si *Muhamedi, Omar Khajami, Avicena dhe Justiniani në zhvillimet historike, kulturore dhe shkencore të kohës.* **Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën** Mësuesi organizon klasën në grupe pune dhe realizon teknikën **"Turi i galerisë"**. Në klasë vendosen postera, harta, figura historike dhe materiale informative në stacione të ndryshme. Çdo grup kalon nga një stacion në tjetrin dhe plotëson detyrat përkatëse. **Stacioni 1 – Shkenca dhe mjekësia** - Nxënësit analizojnë kontributet e Avicenës dhe zhvillimin e mjekësisë arabe. **Stacioni 2 – Matematika dhe astronomia** - Nxënësit analizojnë kontributet e Omar Khajamit dhe zhvillimin e algjebrës, matematikës dhe astronomisë. **Stacioni 3 – Arti dhe arkitektura**

- Nxënësit analizojnë tiparet e artit islam, xhamive, mozaikëve dhe kaligrafisë.

Stacioni 4 – Qytetet dhe kultura

- Nxënësit analizojnë zhvillimin e Bagdadit, Damaskut dhe Kordobës si qendra të dijes dhe kulturës.

Stacioni 5 – Figurat historike

- Nxënësit identifikojnë dhe përshkruajnë figurat historike: Muhamedi, Justiniani, Omar Khajami dhe Avicena.

Gjatë punës, grupet përdorin harta, ilustrime, tabela, materiale digjitale dhe burime historike për të mbledhur informacion dhe për të ndërtuar argumentet e tyre.

Në fazën përmbyllëse, nxënësit ndërtojnë një tabelë ku evidentojnë arritjet kryesore të qytetërimit arab dhe ndikimin e tyre në Evropë.

Fusha	Arritjet kryesore	Ndikimi në Evropë
Mjekësi	Avicena dhe librat mjekësorë	Zhvillimi i mjekësisë evropiane
Matematikë	Algjebra dhe numrat arabë	Përparimi i matematikës
Astronomi	Observatorët dhe studimet astronomike	Zhvillimi i astronomisë
Art dhe arkitekturë	Xhami, mozaikë, kaligrafi	Ndikim në art dhe arkitekturë
Kulturë	Biblioteka dhe përkthimet	Ruajtja dhe përhapja e dijes

Mësuesi nxit mendimin kritik me pyetje të tilla, si:

- Pse qytetet arabe u bënë qendra të dijes?
- Si ndikuan dijetarët arabë në zhvillimin e shkencës evropiane?
- Cilat arritje të qytetërimit arab përdoren edhe sot?
- Pse arti islam kishte tipare të veçanta?

	Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve Në fund të veprimtarisë, nxënësit diskutojnë mbi rëndësinë e qytetërimit arab në zhvillimin e kulturës dhe shkencës botërore dhe evidentojnë figurat historike që lanë gjurmë në histori. Nxënësit plotësojnë një reflektim të shkurtër me pyetjen: "Cila nga arritjet e qytetërimit arab mendoni se ka ndikuar më shumë në jetën e njerëzve sot dhe pse?" Kjo veprimtari i ndihmon nxënësit të kuptojnë kontributin e qytetërimit arab në zhvillimin e njerëzimit, të interpretojnë informacionin historik dhe të zhvillojnë mendimin kritik. ***Kompetencat që zhvillon nxënësi*** *Kompetenca historike:* - përdor dhe interpreton informacionin historik nga burime të ndryshme; - përshkruan arritjet e qytetërimit arab në art, kulturë dhe shkencë; - analizon ndikimin e qytetërimit arab në zhvillimin e Evropës; - njeh dhe vlerëson figurat historike të kësaj periudhe; - përdor harta, ilustrime dhe organizues grafikë për interpretimin e informacionit historik; - zhvillon mendimin kritik dhe argumentimin historik. *Kompetenca kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës:* - kompetenca e komunikimit , përmes diskutimeve, prezantimit dhe argumentimit; - kompetenca personale, përmes bashkëpunimit dhe reflektimit; - kompetenca qytetare, përmes vlerësimit të dialogut kulturor dhe ndikimit të qytetërimeve në zhvillimin e shoqërisë; - kompetenca për sipërmarrjen, përmes organizimit të punës në grup dhe marrjes së përgjegjësive;

	- kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, përmes njohjes së trashëgimisë artistike dhe kulturore arabe; - kompetenca digjitale, në rastet kur përdoren materiale audiovizive, harta digjitale dhe prezantime elektronike.

Tabela 5. Shembuj veprimtarish mësimore për përmbushjen e RN në tematikën "Zhvillimet politike dhe shoqërore në mesjetën e mesme, shek. XI – XIII."

Rezultatet e të nxënit	*Veprimtari mësimore*
6RN(Mm-NQME)4.1.4: *Nxënësi përcakton strukturën shoqërore të Evropës mesjetare si dhe krahason mënyrën e jetesës së shoqërisë në Evropën mesjetare.*	**Situata e të nxënit** Mësuesi nis veprimtarinë duke paraqitur një situatë problemore: *"Imagjinoni se jetoni në Evropën mesjetare. Disa njerëz jetojnë në kështjella dhe kanë toka e pasuri, ndërsa të tjerë punojnë tokën dhe varen nga zotërinjtë feudalë. Si mendoni se ishte e organizuar shoqëria mesjetare?"* Nxënësit japin spontanisht mendimet e tyre. Më pas, mësuesi paraqet ilustrime, harta ose skema të jetës në Evropën mesjetare: kështjella feudale, kalorës, fshatarë, qytete mesjetare, klerikë dhe zejtarë. Nxënësit vëzhgojnë materialet dhe diskutojnë mbi mënyrën e jetesës së shtresave të ndryshme shoqërore. *Pjesët kryesore të një kështjelle mesjetare* 

	Jeta në një qytet mesjetar *Pamje e një qyteti mesjetar*

Dante Aligieri – figurë e kulturës mesjetare

Ilustrim i një tregu mesjetar

	Katedrale gotike mesjetare *Kalorës mesjetarë në betejë*

Struktura shoqërore e Evropës mesjetare



Analiza dhe interpretimi i situatës

Nxënësit diskutojnë për pyetje të tilla, si:

- Çfarë kuptoni me fjalën "feudalizëm"?

- Si ishte e organizuar shoqëria mesjetare?

- Cilat shtresa shoqërore kishin më shumë privilegje?

- Si ndryshonte jeta e fisnikëve nga ajo e fshatarëve?

Mësuesi udhëheq diskutimin për të evidentuar shtresat kryesore të shoqërisë mesjetare: *fisnikët, klerin, kalorësit, zejtarët, tregtarët dhe fshatarët.*

Nxënësit analizojnë gjithashtu ndryshimet në *jetesë, punë, veshje, banesa dhe të drejta shoqërore ndërmjet shtresave të ndryshme.*

Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën

	Mësuesi organizon klasën në grupe pune dhe realizon teknikën “Diagrami i Venit” dhe “Tabela krahasuese”. - ***Grupi 1 – Fisnikët dhe kalorësit*** - Nxënësit analizojnë jetën e fisnikëve, kalorësve dhe rolin e tyre në shoqërinë feudale. ***Grupi 2 – Kleri*** - Nxënësit analizojnë rolin e kishës dhe jetën e klerikëve në Evropën mesjetare. ***Grupi 3 – Fshatarët dhe bujkrobërit*** - Nxënësit përshkruajnë jetën e fshatarëve, punën dhe detyrimet ndaj zotërinjve feudalë. ***Grupi 4 – Qytetet dhe zejtarët*** - Nxënësit analizojnë zhvillimin e qyteteve, tregtisë dhe zejtarëve gjatë Mesjetës. Çdo grup plotëson një tabelë krahasuese për mënyrën e jetesës së shtresave të ndryshme shoqërore. ***Më pas, grupet përdorin Diagramin e Venit për të krahasuar:*** - jetën e fisnikëve dhe fshatarëve; - jetën në qytet dhe në fshat; - privilegjet dhe detyrimet e shtresave të ndryshme. Gjatë punës, nxënësit përdorin ilustrime, skema, materiale historike dhe burime digjitale për të ndërtuar argumentet dhe krahasimet e tyre. Mësuesi nxit mendimin kritik me pyetje të tilla, si: - Pse shoqëria mesjetare ishte e ndarë në shtresa? - Cila shtresë kishte më shumë privilegje dhe pse? - Si ndikonte feudalizmi në jetën e njerëzve? - Cilat ndryshime dalloni ndërmjet jetës në qytet dhe në fshat?

	Në fazën përmbyllëse, nxënësit ndërtojnë një skemë të strukturës shoqërore të Evropës mesjetare. ***Kompetencat që zhvillon nxënësi*** *Kompetenca historike:* - përdor dhe interpreton informacionin historik nga burime të ndryshme; - përcakton strukturën shoqërore të Evropës mesjetare; - krahason mënyrën e jetesës së shtresave të ndryshme shoqërore; - përdor organizues grafikë, tabela krahasuese dhe Diagramin e Venit për interpretimin e informacionit historik; - analizon ndikimin e feudalizmit në jetën e njerëzve; - evidenton dallimet ndërmjet jetës në qytet dhe në fshat gjatë Mesjetës; - zhvillon mendimin kritik dhe argumentimin historik. *Kompetenca kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës:*

	- kompetenca e komunikimit , përmes diskutimeve, argumentimit dhe prezantimit të ideve; - kompetenca personale, përmes bashkëpunimit, reflektimit dhe vetëvlerësimit; - kompetenca qytetare, përmes kuptimit të organizimit shoqëror dhe marrëdhënieve ndërmjet shtresave shoqërore; - kompetenca për sipërmarrjen, përmes organizimit të punës në grup dhe marrjes së përgjegjësive gjatë realizimit të detyrave; - kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, përmes njohjes së jetës, kulturës dhe trashëgimisë mesjetare; - kompetenca digjitale, në rastet kur përdoren materiale digjitale, ilustrime, harta, prezantime elektronike ose burime online.
6RN(Mm-MQP&L)4.2.3: *Nxënësi evidenton pasojat e kryqëzatave në marrëdhëniet mes dy qytetërimeve.*	**Situata e të nxënit** Mësuesi nis veprimtarinë duke paraqitur një situatë problemore: *"Imagjinoni dy qytetërime me kultura, fe dhe mënyra jetese të ndryshme që fillimisht përballen në luftë, por më pas shkëmbejnë njohuri, mallra dhe ide. A mendoni se luftërat sjellin vetëm pasoja negative?"* Nxënësit japin spontanisht mendimet e tyre. Më pas, mësuesi paraqet harta të kryqëzatave, ilustrime të kalorësve kryqtarë, qyteteve mesjetare, tregtisë ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit, si dhe pamje të kontakteve kulturore ndërmjet qytetërimit evropian dhe atij arab. Nxënësit vëzhgojnë materialet dhe diskutojnë mbi marrëdhëniet ndërmjet dy qytetërimeve gjatë Mesjetës. - Harta e kryqëzatave në Mesjetë - Kalorësit kryqtarë në Mesjetë - Takimet ndërmjet qytetërimeve gjatë kryqëzatave

- Tregtia ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit
- Qytetet mesjetare dhe zhvillimi i tregtisë

Analiza dhe interpretimi i situatës

Vëzhgoni hartën dhe ilustrimet, më pas përgjigjuni pyetjeve të mëposhtme:

Mësuesi e ndan klasën në 3 grupe dhe udhëheq diskutimin për të evidentuar pasojat kryesore të kryqëzatave: *zhvillimin e tregtisë; kontaktet kulturore ndërmjet qytetërimeve; përhapjen e njohurive shkencore dhe kulturore; dobësimin e marrëdhënieve ndërmjet të krishterëve dhe myslimanëve; ndikimin në zhvillimin e qyteteve evropiane.*

Nxënësit analizojnë gjithashtu ndikimet pozitive dhe negative të kryqëzatave në marrëdhëniet mes qytetërimeve.

Grupi i parë: *Harta e tre kryqëzatave të para (1096–1192)*



- Cilat ishin drejtimet kryesore të kryqëzatave?
- Nga cilat vende evropiane nisën ushtritë kryqtare?
- Cili ishte destinacioni kryesor i kryqtarëve?
- Çfarë tregojnë vijat me ngjyra në hartë?
- Cilat shtete kryqtare u krijuan në Lindjen e Afërt?
- Në cilën zonë u përqendruan më shumë zotërimet kryqtare?
- Pse Jerusalemi kishte rëndësi të madhe për kryqtarët?

- Cilat dete dhe territore kalonin ushtritë kryqtare gjatë rrugës?
- Çfarë tregon harta për marrëdhëniet mes Evropës dhe Lindjes gjatë Mesjetës?
- Cilat mund të kenë qenë vështirësitë e ushtrive kryqtare gjatë udhëtimit?
- Si ndikuan kryqëzatat në kontaktet tregtare dhe kulturore mes dy qytetërimeve?
- Cilat qytete ose kështjella kryqtare dallohen në hartë?
- Pse mendoni se shtetet kryqtare nuk mbijetuan për një kohë të gjatë?
- Çfarë përfitimesh dhe pasojash sollën kryqëzatat për Evropën dhe Lindjen?
- Çfarë informacioni historik mund të nxjerrim nga kjo hartë?

Grupi i dytë: *Kalorësit kryqtarë gjatë kryqëzatave në Mesjetë*

Çfarë tregon ilustrimi "*Kalorësit kryqtarë gjatë kryqëzatave në Mesjetë* "për kontaktet mes Lindjes dhe Perëndimit?

- Çfarë elementesh të qytetërimeve dallohen në figurë?
- Çfarë kuptoni me fjalën "kryqëzatë"?
- Pse u organizuan kryqëzatat?
- Si ndikuan kryqëzatat në marrëdhëniet ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit?
- A sollën kryqëzatat vetëm luftëra apo edhe shkëmbime kulturore?

Grupi i tretë: *Rrethimi i Jerusalemit nga kryqtarët (1099), miniaturë mesjetare.*

-Çfarë paraqet ilustrimi?

-Cilët personazhe dallohen në figurë?

-Çfarë elementesh tregojnë se bëhet fjalë për kryqëzatat?

-Si paraqiten kalorësit kryqtarë në ilustrim?

-Çfarë simbolesh fetare dallohen në miniaturë?

-Pse Jerusalemi kishte rëndësi të madhe për kryqtarët?

-Çfarë tregon ilustrimi për marrëdhëniet mes Lindjes dhe Perëndimit?

-A paraqet ilustrimi më shumë aspektin fetar apo ushtarak të kryqëzatave?

-Çfarë emocionesh ose mesazhesh përcjell kjo miniaturë?

-Çfarë informacioni historik mund të nxjerrim nga ky ilustrim?

- Si mendoni se ndikoi pushtimi i Jerusalemit në marrëdhëniet mes të krishterëve dhe myslimanëve?
- A mendoni se ilustrimi paraqet ngjarjen në mënyrë objektive apo idealizuese? Pse?

<table>
<tr>
<td></td>
<td>
Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën
Mësuesi organizon klasën në grupe pune dhe realizon teknikën “Tabela T” dhe “Debati historik”.
Grupi 1 – Pasojat pozitive të kryqëzatave
- Nxënësit evidentojnë zhvillimin e tregtisë, shkëmbimet kulturore dhe përhapjen e njohurive.
Grupi 2 – Pasojat negative të kryqëzatave
- Nxënësit evidentojnë luftërat, shkatërrimet dhe përkeqësimin e marrëdhënieve fetare.
Grupi 3 – Ndikimi në Evropë
- Nxënësit analizojnë ndikimin e kryqëzatave në zhvillimin ekonomik dhe urban të Evropës.
Grupi 4 – Ndikimi në Lindje
- Nxënësit analizojnë pasojat që kryqëzatat sollën në qytetërimet lindore.
Çdo grup plotëson një Tabelë T ku evidentohen pasojat pozitive dhe negative të kryqëzatave.
<table>
<tr><th>Pasojat pozitive</th><th>Pasojat negative</th></tr>
<tr><td>Zhvillimi i tregtisë</td><td>Luftëra dhe shkatërrime</td></tr>
<tr><td>Shkëmbime kulturore</td><td>Konflikte fetare</td></tr>
<tr><td>Përhapja e njohurive</td><td>Dobësim i marrëdhënieve ndërmjet qytetërimeve</td></tr>
<tr><td>Zhvillimi i qyteteve</td><td>Humbje njerëzore dhe ekonomike</td></tr>
</table>
Më pas, grupet zhvillojnë një debat historik me temën: “A ndikuan më shumë kryqëzatat pozitivisht apo negativisht në marrëdhëniet ndërmjet qytetërimeve?”
Mësuesi nxit mendimin kritik me pyetje të tilla, si:
- Pse kryqëzatat ndikuan në zhvillimin e tregtisë?
</td>
</tr>
</table>

	- Si u përhapën njohuritë nga Lindja në Evropë? - Pse marrëdhëniet ndërmjet qytetërimeve u tensionuan pas kryqëzatave? - Cilat pasoja të kryqëzatave ndikojnë ende sot? **Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve** Në fund të veprimtarisë, nxënësit ndërtojnë një hartë konceptuale ku evidentojnë pasojat politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore të kryqëzatave në marrëdhëniet ndërmjet qytetërimeve lindore dhe perëndimore. Kjo veprimtari i ndihmon nxënësit të kuptojnë ndikimin e kryqëzatave në historinë mesjetare, të analizojnë marrëdhëniet ndërmjet qytetërimeve dhe të zhvillojnë mendimin kritik. ***Kompetencat që zhvillon nxënësi*** *Kompetenca historike:* - përdor dhe interpreton informacionin historik nga burime të ndryshme; - evidenton pasojat e kryqëzatave në marrëdhëniet ndërmjet qytetërimeve; - analizon ndikimet pozitive dhe negative të kryqëzatave; - përdor tabela krahasuese dhe organizues grafikë për interpretimin e informacionit historik; - krahason ndikimin e kryqëzatave në Lindje dhe në Perëndim; - zhvillon mendimin kritik dhe argumentimin historik. *Kompetenca kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës:* - kompetenca e komunikimit , përmes debatit, diskutimeve dhe prezantimit të argumenteve; - kompetenca personale, përmes bashkëpunimit dhe reflektimit; - kompetenca qytetare, përmes kuptimit të marrëdhënieve ndërmjet qytetërimeve dhe ndikimit të konflikteve në shoqëri;

	- kompetenca për sipërmarrjen, përmes organizimit të punës në grup dhe marrjes së përgjegjësive; - kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, përmes njohjes së kontakteve dhe shkëmbimeve kulturore ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit; - kompetenca digjitale, në rastet kur përdoren materiale digjitale, harta, ilustrime dhe prezantime elektronike.

Tabela 6. Shembuj veprimtarish mësimore për përmbushjen e RN në tematikën "Evropa në mesjetën e vonë, shek. XIV – XV."

Rezultatet e të nxënit	*Veprimtari mësimore*
6RN(Mv-MF)5.3.3: Nxënësi dallon ndryshimet ndërmjet monarkisë franceze dhe angleze.	**Situata e të nxënit** Mësuesi nis veprimtarinë duke paraqitur një situatë problemore: *"Imagjinoni dy mbretëri mesjetare: në njërën mbreti ka pushtet shumë të madh dhe merr vetë shumicën e vendimeve, ndërsa në tjetrën pushteti i mbretit kufizohet nga ligjet dhe nga një kuvend. Si mendoni se ndryshon mënyra e qeverisjes dhe jeta e njerëzve në këto dy mbretëri?"* Nxënësit japin spontanisht mendimet e tyre. Më pas, mësuesi paraqet harta, ilustrime ose skema të Francës dhe Anglisë mesjetare, figura të mbretërve francezë dhe anglezë, pamje të parlamenteve, kështjellave dhe jetës oborrtare mesjetare. Nxënësit vëzhgojnë materialet dhe diskutojnë mbi mënyrën e organizimit të dy monarkive. - *Harta e Francës dhe Anglisë në Mesjetë* - *Monarkia franceze në Mesjetë* - *Parlamenti anglez në Mesjetë* - *Jeta në oborret mbretërore mesjetare* **Analiza dhe interpretimi i situatës** Nxënësit diskutojnë për pyetje të tilla, si:

	- Çfarë kuptoni me fjalën “monarki”? - Pse mbretërit kërkonin më shumë pushtet? - Si ndryshonte pushteti i mbretit në Francë dhe në Angli? - Çfarë roli kishte parlamenti në Angli? Mësuesi udhëheq diskutimin për të evidentuar tiparet kryesore të monarkisë franceze dhe angleze: - forcimin e pushtetit mbretëror në Francë; - zhvillimin e parlamentit dhe kufizimin e pushtetit mbretëror në Angli; - rolin e fisnikëve dhe të ligjeve; - ndryshimet në organizimin politik të dy shteteve. **Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën** Mësuesi organizon klasën në grupe pune dhe realizon teknikën *“Diagrami i Venit” dhe “Loja me role”*. ***Grupi 1 – Monarkia franceze*** - Nxënësit analizojnë pushtetin e mbretit francez, rolin e fisnikëve dhe organizimin e shtetit francez. ***Grupi 2 – Monarkia angleze*** - Nxënësit analizojnë rolin e parlamentit, Magna Carta-s dhe kufizimin e pushtetit mbretëror në Angli. ***Grupi 3 – Krahasimi ndërmjet dy monarkive*** - Nxënësit përdorin Diagramin e Venit për të evidentuar ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet monarkisë franceze dhe angleze. ***Grupi 4 – Loja me role*** - Nxënësit simulojnë një debat ndërmjet një mbreti francez dhe një fisniku anglez mbi pyetjen: “A duhet mbreti të ketë pushtet absolut?”

Mësuesi paraqet modelin e mëposhtëm të Diagramit të Venit:

Monarkia franceze	**Monarkia angleze**
Mbret me pushtet më të madh	Pushteti i mbretit më i kufizuar
Shtet më i centralizuar	Parlament me rol të rëndësishëm
Roli i madh i oborrit mbretëror	Magna Carta dhe ligjet
Më pak kufizime ndaj mbretit	Rritje e rolit të fisnikëve dhe parlamentit

Kjo veprimtari i ndihmon nxënësit të kuptojnë zhvillimet politike në Evropën mesjetare, të krahasojnë format e ndryshme të monarkisë dhe të zhvillojnë mendimin kritik.

- Monarkia franceze në Mesjetën e vonë po shkonte drejt forcimit të pushtetit mbretëror dhe centralizimit.
- Në Angli, pas Magna Carta (1215), pushteti i mbretit filloi të kufizohej gradualisht nga fisnikët dhe parlamenti.
- "Parlamenti" vetëm nuk mjafton; duhet lidhur me kufizimin e pushtetit mbretëror.
- "Magna Carta dhe ligjet" është formulim shumë i saktë.
- "Rritje e rolit të fisnikëve dhe parlamentit" është historikisht më korrekt sesa vetëm "fisnikëve".

Kompetencat që zhvillon nxënësi

Kompetenca historike:

- përdor dhe interpreton informacionin historik nga burime të ndryshme;
- dallon ndryshimet ndërmjet monarkisë franceze dhe angleze;
- krahason organizimin politik të dy monarkive mesjetare;
- përdor tabela krahasuese dhe Diagramin e Venit për interpretimin e informacionit historik;

	- analizon rolin e parlamentit dhe të pushtetit mbretëror në Mesjetë; - zhvillon mendimin kritik dhe argumentimin historik. *Kompetenca kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës:* - kompetenca e komunikimit , përmes diskutimeve, debatit dhe prezantimit të argumenteve; - kompetenca personale, përmes bashkëpunimit dhe reflektimit; - kompetenca qytetare, përmes kuptimit të organizimit politik dhe rolit të institucioneve; - kompetenca për sipërmarrjen, përmes organizimit të punës në grup dhe ndarjes së detyrave; - kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, përmes njohjes së trashëgimisë politike mesjetare; - kompetenca digjitale, në rastet kur përdoren materiale digjitale, ilustrime, harta dhe prezantime elektronike.
6RN(Mv-kbQM)5.5.4: Nxënësi ndërton linjën e kohës për periudhën mesjetare.	**Situata e të nxënit** Mësuesi nis veprimtarinë duke paraqitur një situatë problemore: *"Imagjinoni sikur duhet të tregoni historinë e Mesjetës vetëm përmes ngjarjeve më të rëndësishme. Cilat ngjarje do të zgjidhnit dhe si do t'i organizonit ato në kohë?"* Nxënësit japin spontanisht mendimet e tyre. Më pas, mësuesi paraqet harta, ilustrime, figura historike dhe data kryesore që lidhen me temat e trajtuara gjatë *Mesjetës së hershme, të mesme dhe të vonë*. Nxënësit vëzhgojnë materialet dhe diskutojnë mbi zhvillimet më të rëndësishme politike, shoqërore, kulturore dhe fetare të periudhës mesjetare. **Analiza dhe interpretimi i situatës** Nxënësit diskutojnë për pyetje të tilla, si: - Çfarë kuptoni me "linjë kohe"? - Pse është e rëndësishme renditja kronologjike e ngjarjeve?

	- Cilat ngjarje mendoni se kanë ndikuar më shumë në historinë e Mesjetës? - Si ndryshoi Evropa nga Mesjeta e hershme deri në Mesjetën e vonë? Mësuesi udhëheq diskutimin për të evidentuar zhvillimet kryesore të periudhës mesjetare: *fuqizimin e Bizantit; zhvillimin e qytetërimit arab; kryqëzatat; lindjen e qyteteve dhe shtet-kombeve; zhvillimin e monarkive evropiane; zgjerimin e Perandorisë Osmane; zhvillimet kulturore dhe fetare.* **Shpjegimi dhe komunikimi për të shkuarën** Mësuesi organizon klasën në grupe pune dhe realizon teknikën "Linja e kohës". Çdo grup merr një periudhë ose tematikë të caktuar: ***Grupi 1 – Mesjeta e hershme (shek. V–X)*** - Nxënësit evidentojnë ngjarje si: krijimi i Perandorisë Bizantine, Justiniani, zhvillimi i qytetërimit arab dhe përhapja e Islamit. ***Grupi 2 – Mesjeta e mesme (shek. XI–XIII)*** - Nxënësit evidentojnë kryqëzatat, zhvillimin e qyteteve mesjetare dhe ndryshimet në shoqërinë feudale. ***Grupi 3 – Mesjeta e vonë (shek. XIV–XV)*** - Nxënësit evidentojnë fillesat e shtet-kombeve, zhvillimin e monarkive evropiane dhe zgjerimin e Perandorisë Osmane. ***Grupi 4 – Kultura dhe besimi në Mesjetë*** - Nxënësit evidentojnë zhvillimet kulturore, arkitekturën gotike, universitetet dhe figurat historike kryesore. Çdo grup përzgjedh datat dhe ngjarjet më të rëndësishme dhe i vendos në mënyrë kronologjike në një vijë horizontale ose poster të përbashkët. Nxënësit përdorin ngjyra, figura, simbole dhe ilustrime për të dalluar periudhat dhe temat

	kryesore. Gjatë punës, nxënësit përdorin tekste historike, ilustrime, harta, materiale digjitale dhe burime online për të mbledhur informacion dhe për të ndërtuar linjën e kohës. Mësuesi nxit mendimin kritik me pyetje të tilla, si: - Cilat ngjarje ndryshuan më shumë historinë e Mesjetës? - Si ndikoi qytetërimi arab në Evropë? - Pse kryqëzatat konsiderohen një moment i rëndësishëm historik? - Si ndryshoi organizimi politik i Evropës gjatë Mesjetës? ***Shembull:*** Grupi 4 – Kultura dhe besimi në Mesjetë shek. XI–XIII | Ndërtimi i katedraleve gotike shek. XII | Krijimi i universiteteve të para 1200–1400 | Zhvillimi i kulturës mesjetare dhe artit gotik shek. XV | Humanizmi dhe rilindja kulturore në Evropë Ngjarje kryesore: - Zhvillimi i arkitekturës gotike - Hapja e universiteteve të para - Zhvillimi i kulturës dhe artit mesjetar - Roli i fesë në jetën mesjetare **Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve** Në fund të veprimtarisë, nxënësit prezantojnë linjën e kohës dhe shpjegojnë lidhjen ndërmjet ngjarjeve historike. Ata diskutojnë mbi ndryshimet dhe vazhdimësitë që karakterizuan Mesjetën dhe evidentojnë ngjarjet që patën ndikim më

	të madh në zhvillimin e qytetërimeve evropiane dhe lindore. Kjo veprimtari i ndihmon nxënësit të kuptojnë kronologjinë historike, lidhjen ndërmjet ngjarjeve dhe zhvillimin e qytetërimeve gjatë periudhës mesjetare. ***Kompetencat që zhvillon nxënësi*** *Kompetenca historike:* - përdor dhe interpreton informacionin historik nga burime të ndryshme; - ndërton dhe interpreton linjën e kohës për periudhën mesjetare; - rendit kronologjikisht ngjarjet dhe zhvillimet kryesore historike; - analizon lidhjen shkak–pasojë ndërmjet zhvillimeve historike; - evidenton ndryshimet dhe vazhdimësitë gjatë Mesjetës; - zhvillon mendimin kritik dhe argumentimin historik. *Kompetenca kyçe për të nxënit gjatë gjithë jetës:* - kompetenca e komunikimit , përmes diskutimeve dhe prezantimit të linjës së kohës; - kompetenca personale, përmes bashkëpunimit dhe reflektimit; - kompetenca qytetare, përmes kuptimit të zhvillimeve historike dhe marrëdhënieve ndërmjet qytetërimeve; - kompetenca për sipërmarrjen, përmes organizimit të punës në grup dhe ndarjes së detyrave; - - kompetenca për vetëdijen dhe shprehjen kulturore, përmes njohjes së trashëgimisë historike dhe kulturore mesjetare; - kompetenca digjitale, në rastet kur përdoren materiale digjitale, harta, ilustrime dhe prezantime elektronike.

2. LËNDA: GJEOGRAFI

Veprimtaritë praktike në lëndën e gjeografisë

Veprimtaritë praktike në lëndën e gjeografisë përfaqësojnë një qasje aktive dhe të përqendruar te nxënësi, ku të nxënit zhvillohet përmes vëzhgimit, eksplorimit dhe analizës së dukurive natyrore, mjedisore dhe shoqërore. Ato ndërtohen duke u nisur nga situata reale ose të lidhura me jetën e përditshme, duke i angazhuar nxënësit në procese konkrete si interpretimi i hartave, analiza e të dhënave, përdorimi i teknologjisë digjitale, diskutimi dhe zgjidhja e problemeve gjeografike. Këto veprimtari ndihmojnë në zhvillimin e kompetencave lëndore, si vëzhgimi dhe hetimi i dukurive gjeografike, mbledhja dhe interpretimi i informacionit gjeografik, si edhe marrja e vendimeve mbi bazën e të dhënave të analizuara. Ato lidhen drejtpërdrejt me rezultatet e të nxënit (RN), pasi çdo hap i veprimtarisë është i orientuar drejt demonstrimit praktik të njohurive dhe aftësive të nxënësve, duke e bërë të nxënit më konkret, ndërveprues dhe të lidhur me realitetin. Më poshtë jepen disa modele të veprimtarive praktike, të cilat mësuesi mund t'i përshtatë dhe pasurojë sipas nivelit të klasës, interesave dhe nevojave të nxënësve, si edhe sipas kontekstit lokal dhe burimeve që ofron mjedisi i shkollës dhe komuniteti.

Tabela 1. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve në nëntematikën "Gjeografia dhe kërkimi gjeografik"

Rezultat i të nxënit	*Veprimtari praktike*
Nxënësi diferencon ngjarje të rëndësishme të historisë së zhvillimit gjeografik.	***Situata e të nxënit.*** Mësuesi paraqet fotografi dhe ilustrime që tregojnë mënyra të ndryshme se si njerëzit kanë njohur dhe orientuar botën ndër shekuj: një hartë të vjetër të botës, një anije të udhëtimeve të mëdha detare, një busull dhe një hartë digjitale.

	Nxënësit vëzhgojnë figurat dhe diskutojnë: • Si orientoheshin njerëzit shumë kohë më parë? • Si i zbulonin vendet e reja? • Si orientohen njerëzit sot? Mësuesi drejton pyetjen problemore: *"Si kanë ndryshuar njohuritë e njerëzve për botën nga e kaluara deri në ditët e sotme?"* ***Veprimet në situatë /Zgjidhja e problemit.*** Nxënësit ndahen në grupe dhe secili grup hulumton për një moment të rëndësishëm të zhvillimit gjeografik përmes figurave, hartave ose materialeve të thjeshta informuese. ***Grupi 1: Hartat e para dhe orientimi.*** Nxënësit vëzhgojnë harta të vjetra dhe i krahasojnë me hartat moderne. Ata analizojnë mënyrën si paraqitej bota në periudha të ndryshme historike, duke evidentuar ndryshimet në formën e kontinenteve, përmasat e oqeaneve dhe informacionin gjeografik të paraqitur në hartë. Gjatë krahasimit të hartave, nxënësit diskutojnë rreth pyetjeve: • Cilat pjesë të botës mungojnë ose paraqiten jo saktë në hartat e vjetra? • Pse hartat e vjetra kishin më pak informacion? • Si ndikuan udhëtimet dhe eksplorimet në përmirësimin e hartave?

	Nëpërmjet vëzhgimit dhe krahasimit të hartave, nxënësit kuptojnë se njohuritë gjeografike janë zhvilluar gradualisht dhe se hartat janë bërë më të sakta falë eksplorimeve, matjeve dhe zhvillimit të teknologjisë. ***Grupi 2: Udhëtimet e mëdha detare.*** Nxënësit studiojnë hartat e udhëtimeve të Kristofor Kolombit dhe Magelanit dhe evidentojnë rrugët kryesore të eksplorimeve detare. Ata përcaktojnë në hartë drejtimet e udhëtimeve, oqeanet e përshkuara dhe territoret e zbuluara gjatë ekspeditave. Gjatë analizës së hartave, nxënësit diskutojnë: ▪ Cilat kontinente dhe oqeane u njohën më mirë pas këtyre udhëtimeve? ▪ Pse udhëtimet detare ndryshuan mënyrën si njerëzit e kuptonin botën? ▪ Çfarë vështirësish mund të kenë hasur eksploruesit gjatë udhëtimeve të tyre? 

	Nxënësit krahasojnë hartat para dhe pas udhëtimeve të mëdha gjeografike dhe arrijnë në përfundimin se eksplorimet detare zgjeruan njohuritë për Tokën, përmirësuan hartat dhe ndihmuan në zhvillimin e tregtisë, komunikimit dhe lidhjeve ndërmjet kontinenteve. ***Grupi 3: Zhvillimi i mjeteve të orientimit.*** Nxënësit njihen me mjete të ndryshme orientimi të përdorura në periudha të ndryshme historike: p.sh., busullën, hartat tradicionale dhe hartat digjitale (p.sh., GPS-in). Ata vëzhgojnë ilustrimet për secilin mjet dhe diskutojnë mënyrën si njerëzit orientoheshin në të kaluarën dhe si orientohen sot. Nxënësit krahasojnë përdorimin e mjeteve tradicionale me teknologjitë moderne dhe diskutojnë: • Cilat ishin vështirësitë e orientimit në të kaluarën? • Si e ka lehtësuar teknologjia udhëtimin dhe eksplorimin? • Në cilat situata përdorim sot harta digjitale? Përmes krahasimit dhe interpretimit të ilustrimeve, nxënësit kuptojnë se zhvillimi i mjeteve të orientimit ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjerimin e njohurive gjeografike dhe në mënyrën si njerëzit lëvizin dhe eksplorojnë botën sot. ***Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve.*** Më pas, nxënësit bashkëpunojnë për të ndërtuar në një poster të madh një vijë kohe të zhvillimit gjeografik. Ata rendisin në mënyrë kronologjike:

	• hartat e para dhe përfytyrimet e hershme të botës; • shpikjen dhe përdorimin e busullës; • udhëtimet e mëdha gjeografike të eksploruesve; • zhvillimin e hartografisë moderne, imazheve satelitore dhe GPS-it. Gjatë ndërtimit të vijës së kohës, nxënësit krahasojnë periudhat historike dhe evidentojnë mënyrën si njohuritë gjeografike janë zgjeruar gradualisht. Ata diskutojnë se si çdo zhvillim ka ndihmuar njerëzit të orientohen më mirë, të eksplorojnë territore të reja dhe të krijojnë harta më të sakta. Në fazën e prezantimit, çdo grup shpjegon: • Çfarë paraqet karta e tyre? • Pse kjo ngjarje ose shpikje ishte e rëndësishme? • Si ndikoi ajo në njohjen e botës dhe në jetën e njerëzve? Nxënësit zhvillojnë aftësinë për të kuptuar evolucionin e njohurive gjeografike dhe për të lidhur zhvillimet historike me përdorimin e teknologjisë në jetën e sotme.
Rezultat i të nxënit	***Veprimtari praktike***
Nxënësi diskuton mbi rolin e gjeografit në studimin e dukurive fizike dhe humane gjeografike, kontributet që i sjellin shoqërisë.	***Situata e të nxënit.*** Mësuesi paraqet disa fotografi dhe situata nga jeta reale: • një ekspert që analizon përmbytjet; • një meteorolog që studion motin; • një hartograf që punon me harta digjitale; • një gjeograf që po studion pse në disa zona të qytetit ajri është më i ndotur dhe si ndikon trafiku tek njerëzit.

Nxënësit vëzhgojnë figurat dhe zhvillojnë një diskutim të lirë:

- Çfarë pune po bëjnë këta njerëz?
- Çfarë problemesh po përpiqen të zgjidhin?
- Si ndihmon puna e tyre njerëzit dhe komunitetin?

Mësuesi drejton pyetjen problemore: “Çfarë bën një gjeograf dhe pse puna e tij është e rëndësishme për jetën tonë?”

Klasa organizohet si një “takim ekspertësh”. Çdo nxënës ose dyshe nxënësish merr një rol:

- gjeograf i klimës (meteorolog);
- studiues i popullsisë;
- ekspert i mjedisit;
- hartograf;
- gjeograf urban.

Mësuesi paraqet një situatë: “Qyteti ynë po përballet me probleme si trafiku, ndotja dhe përmbytjet. Bashkia ka kërkuar ndihmën e gjeografëve për të gjetur zgjidhje.” Nxënësit përgatisin argumentet e tyre:

- Çfarë problemi do të studiojnë?
- Si mund të ndihmojnë?

	• Çfarë zgjidhjesh propozojnë? ***Veprimet në situatë /Zgjidhja e problemit.*** Klasa organizon një debat të shkurtër në formën e një mbledhjeje të bashkisë së qytetit. Nxënësit ndahen në grupe dhe çdo grup përfaqëson një specialist të ndryshëm (meteorolog, ekspert mjedisi, hartograf, gjeograf urban, studiues i popullsisë) dhe prezanton idetë e veta për problemet e qytetit. Mësuesi merr rolin e drejtuesit të mbledhjes dhe hap diskutimin me pyetjen: "Cili specialist mund të ndihmojë më shumë qytetin dhe pse?" Secili grup prezanton idetë dhe argumentet e veta: - meteorologët shpjegojnë pse parashikimi i motit dhe përmbytjeve është i rëndësishëm; - ekspertët e mjedisit tregojnë mënyra për uljen e ndotjes; - hartografët argumentojnë pse hartat dhe GPS-i ndihmojnë qytetarët dhe shërbimet emergjente; - gjeografët urbanë propozojnë zgjidhje për organizimin e trafikut dhe hapësirave të qytetit; - studiuesit e popullsisë shpjegojnë si ndihmojnë të dhënat për numrin dhe shpërndarjen e banorëve në planifikimin e shërbimeve. Pas prezantimeve, grupet bëjnë pyetje dhe komentojnë idetë e njëri-tjetrit, p.sh.: • Si mund të ndihmojnë hartat gjatë përmbytjeve? • Pse ndotja është më e madhe në disa zona të qytetit? • Si mund të zvogëlohet trafiku? • Pse është e rëndësishme të dimë ku jetojnë më shumë njerëz?

	Nxënësit argumentojnë mendimet e tyre duke përdorur shembuj nga jeta reale, si parashikimi i motit, përdorimi i GPS-it, studimet për ndotjen, menaxhimi i përmbytjeve dhe planifikimi i rrugëve apo qyteteve. Mësuesi i nxit të dëgjojnë njëri-tjetrin, të krahasojnë idetë dhe të argumentojnë përgjigjet e tyre. ***Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve.*** Në përfundim, nxënësit reflektojnë rreth pyetjeve: • Çfarë studion gjeografi? • Si ndihmon puna e gjeografit shoqërinë? • Në cilat situata të jetës së përditshme përdorim njohuritë gjeografike? Përmes diskutimit, analizës së situatave reale dhe roleve praktike, nxënësit kuptojnë se gjeografia nuk lidhet vetëm me hartat dhe natyrën, por ndihmon njerëzit të kuptojnë problemet e mjedisit, të organizojnë qytetet, të parashikojnë rreziqet natyrore dhe të përmirësojnë jetën në komunitet.

Tabela 2. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve në nëntematikën "Hartat gjeografike"

Rezultat i të nxënit	*Veprimtari praktike*
Nxënësi krahason hartën, planin dhe globin duke treguar ngjashmëritë dhe dallimet mes tyre.	***Situata e të nxënit.*** Mësuesi u paraqet nxënësve një sfidë: Klasa do të zhvillojë një udhëtim imagjinar. (a) Fillimisht duhet të gjejmë ku ndodhet Shqipëria, (b) më pas të udhëtojmë drejt një qyteti tjetër dhe (c) në fund të orientohemi brenda një qendre tregtare të madhe ku ndodhet kinemaja. Mësuesi drejton pyetjen problemore: Përgjatë këtyre etapave të udhëtimit, kur do të përdorim globin, hartën dhe planin? Nxënësit diskutojnë rreth pyetjeve: • Çfarë mjeti duhet të përdorim në secilin rast (globin/hartën/planin)? • Pse nuk mund të përdorim vetëm një mjet për të gjitha situatat? • Cili mjet jep më shumë hollësi? ***Veprimet në situatë /Zgjidhja e problemit.***

Sfida 1: Gjej Shqipërinë

Nxënësit punojnë në dyshe ose në grupe të vogla. Çdo grup merr një glob dhe diskuton së bashku për të gjetur Shqipërinë. Një nxënës kërkon vendndodhjen, një tjetër identifikon kontinentin dhe detet përreth, ndërsa të tjerët sugjerojnë vende të tjera që njohin ose ku do të dëshironin të udhëtonin. Pas punës në grup, përfaqësuesit prezantojnë gjetjet e tyre para klasës dhe krahasojnë përgjigjet me grupet e tjera.

Mësuesi nxit diskutimin përmes pyetjeve:

- Pse globi është më i përshtatshëm për të parë Tokën?
- Çfarë nuk mund të shohim qartë në glob?

Nxënësit kuptojnë se globi paraqet Tokën në formën e saj reale, por nuk jep shumë hollësi.

Sfida 2: Planifiko udhëtimin për në qytetin tjetër



Nxënësit punojnë në grupe. Çdo grup merr një hartë të Shqipërisë dhe një "mision udhëtimi", p.sh. të planifikojë rrugën nga Saranda ose Tropoja drejt Tiranës.

Brenda grupit, nxënësit ndajnë detyrat:

a) një nxënës identifikon qytetet;
b) një tjetër kërkon rrugët kryesore;
c) një tjetër evidenton elementet natyrore si lumenjtë, malet ose detin;
d) një nxënës prezanton rrugën e zgjedhur dhe argumenton pse është më e përshtatshme.

	Grupet krahasojnë itineraret dhe diskutojnë si harta ndihmon për orientim dhe planifikim udhëtimesh reale. Mësuesi nxit diskutimin përmes pyetjeve: Pse harta është më praktike për udhëtime? Çfarë informacioni marrim nga harta? Pse harta jep më shumë hollësi se globi? ***Sfida 3: Gjej kinemanë në qendrën tregtare*** Mësuesi paraqet planin e një qendre tregtare ose të një muzeu. Nxënësit punojnë fillimisht individualisht për të vëzhguar planin e qendrës tregtare dhe për të gjetur hyrjen, ashensorët, shkallët dhe rrugën drejt kinemasë ose restorantit. Më pas, ata diskutojnë në dyshe ose në grup: - Cilën rrugë zgjodhën? - Pse ishte më e shkurtër ose më praktike? - Cilat simbole i ndihmuan të orientoheshin? Në fund, disa nxënës tregojnë para klasës rrugën që ndoqën duke përdorur drejtimet dhe elementet e planit.

Nxënësit plotësojnë një tabelë krahasuese ku evidentojnë ngjashmëritë dhe dallimet ndërmjet globit, hartës dhe planit.

Elementi i krahasimit	GLOBI	HARTA	PLANI
Çfarë paraqet?			
Forma e paraqitjes			
Shkalla e hollësisë			
Për çfarë përdoret?			
Ngjashmëritë			

Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve. Në përfundim, nxënësve u kërkohet të analizojnë disa situata konkrete:

a) Nëse humbisni në një qytet të panjohur, cilin prej tyre do të përdornit?
b) Nëse doni të mësoni ku ndodhet një shtet në botë, cili mjet është më i përshtatshëm?
c) Si përdoren sot hartat dhe planet në telefonat inteligjentë?

Përmes sfidave, lojës dhe situatave reale, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të zgjedhur mjetin më të përshtatshëm sipas situatës dhe për të kuptuar përdorimin praktik të globit, hartës dhe planit në jetën e përditshme.

Rezultat i të nxënit	***Veprimtari praktike***
Nxënësi shpjegon legjendën e një harte gjeografike.	***Situata e të nxënit.*** Mësuesi i vendos nxënësit në një situatë nga jeta reale: Një grup turistësh do të vizitojë një park natyror dhe një qytet bregdetar në Shqipëri. Ata kanë një hartë, por legjenda e saj është dëmtuar. Para se të nisen, duhet të kuptojnë çfarë tregojnë simbolet dhe ngjyrat në hartë, në mënyrë që të mos humbasin rrugën dhe të gjejnë vendet kryesore. Mësuesi projekton ose shpërndan një hartë turistike/fizike ku legjenda fillimisht mbulohet. Nxënësit vëzhgojnë hartën dhe, si "ekip guidash", përpiqen të zbulojnë kuptimin e simboleve dhe ngjyrave duke u mbështetur në atë që shohin. Mësuesi nxit diskutimin me pyetje, si: • Çfarë mund të tregojnë vijat blu në hartë? • Pse disa zona janë me ngjyrë jeshile dhe të tjera me ngjyrë kafe? • Çfarë mund të tregojë simboli ✈ ose ⚓? • Si do ta kuptonim rrugën pa shpjegimet e hartës? Nxënësit japin hipoteza dhe argumentojnë mendimet e tyre. Pas diskutimit, mësuesi zbulon legjendën e hartës dhe nxënësit krahasojnë përgjigjet e tyre me kuptimin real të simboleve. Ata kuptojnë se legjenda është "çelësi" që ndihmon për të lexuar hartën. ***Veprimet në situatë /Zgjidhja e problemit.*** Më pas, mësuesi u jep grupeve një "mision" të shkurtër praktik: • Gjeni rrugën për të shkuar nga qyteti tek aeroporti ✈. • Zbuloni ku ndodhet zona malore ▲ e përshtatshme për ecje. • Gjeni një park ose zonë të gjelbër 🌲 pranë liqenit.

	Për të realizuar misionin, nxënësit duhet të përdorin legjendën dhe të interpretojnë simbolet, ngjyrat dhe drejtimet në hartë. Gjatë punës, ata evidentojnë: ▪ ngjyrën blu për lumenjtë, liqenet dhe detin; ▪ ngjyrën jeshile për fushat ose zonat e ulëta; ▪ ngjyrën kafe për malet dhe zonat e larta; ▪ ✈ aeroportin; ▪ ⚓ portin; ▪ rrugët kryesore. Në vijim, mësuesi lidh veprimtarinë me jetën reale duke pyetur: • Ku kemi parë harta me simbole në përditshmëri? • Pse Google Maps përdor simbole dhe ngjyra? • Çfarë do të ndodhte nëse çdo hartë do të përdorte simbole të ndryshme? Nxënësit kuptojnë se legjenda përdoret jo vetëm në hartat e librave, por edhe në aplikacione digjitale. ***Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve.*** Në pjesën përmbyllëse, çdo grup merr si detyrë të krijojë një mini-hartë të një vendi imagjinar (p.sh., ishull turistik) dhe ndërton një legjendë të thjeshtë me simbole të zgjedhura prej tyre. Grupet prezantojnë hartën dhe shpjegojnë: ▪ Çfarë tregojnë simbolet? ▪ Pse zgjodhën ato ngjyra? ▪ Si ndihmon legjenda për të kuptuar hartën? Përmes kësaj veprimtarie, nxënësit kuptojnë në mënyrë konkrete dhe argëtuese se legjenda është pjesa që "i jep kuptim" hartës dhe e bën atë të përdorshme në situata reale të jetës së përditshme.

Rezultat i të nxënit	***Veprimtari praktike***
Nxënësi mat largësinë në vijë ajrore dhe rrugore ndërmjet dy vendeve në harta me shkallë zvogëlimi të ndryshme.	***Situata e të nxënit.*** Një familje nga Tirana dëshiron të udhëtojë drejt Vlorës për pushime. Ata duan të dinë sa larg është Vlora në vijë ajrore dhe sa është gjatësia e rrugës që do të përshkojnë me makinë. Si mund ta gjejnë këtë informacion duke përdorur hartën? Nxënësit diskutojnë: - Pse largësia në vijë ajrore nuk është e njëjtë me atë rrugore? - Cila largësi është më e shkurtër? - Në cilat situata përdorim secilën prej tyre? Mësuesi drejton pyetjen problemore: Si na ndihmon shkalla e hartës për të llogaritur largësitë reale? Mësuesi demonstron në hartë mënyrën e përdorimit të shkallës së zvogëlimit. Ai paraqet dy harta me shkallë të ndryshme dhe shpjegon se si matet largësia në hartë dhe si shndërrohet në largësi reale. Nxënësit vëzhgojnë shembullin dhe evidentojnë se: - sa më e madhe shkalla, aq më shumë hollësi paraqiten në hartë; - largësia reale mbetet e njëjtë, edhe kur ndryshon paraqitja në hartë. ***Veprimet në situatë /Zgjidhja e problemit.*** Nxënësit ndahen në grupe dhe pajisen me harta të Shqipërisë me shkallë të ndryshme, vizore ose spango, laps dhe tabelë pune. ***Detyra 1: Matja e largësisë në vijë ajrore*** Çdo grup zgjedh dy qytete në hartë, p.sh. Tiranë – Vlorë. Nxënësit vendosin vizoren mbi hartë dhe matin largësinë në vijë të drejtë ndërmjet dy qyteteve.



P.sh., në hartë largësia Tiranë–Vlorë del 5 cm. Nëse harta ka shkallën 1: 1 000 000, kjo do të thotë se 1 000 000 cm = 10 000 m = 10 km

Nxënësit kryejnë llogaritjen: 5 cm × 10 km = 50 km.

Pra, ata arrijnë në përfundimin se largësia në vijë ajrore ndërmjet Tiranës dhe Vlorës është rreth 50 km.

Gjatë punës, mësuesi nxit nxënësit diskutojnë:

- Pse kjo largësi quhet "në vijë ajrore"?
- A është kjo rruga reale që përshkohet me makinë?
- Pse rruga reale është zakonisht më e gjatë?

Përmes matjes dhe llogaritjes konkrete, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të përdorur shkallën e hartës në situata reale dhe për të interpretuar marrëdhënien ndërmjet distancës në hartë dhe largësisë reale në terren.

Detyra 2: Matja e distancës rrugore

Nxënësit përdorin një spango ose një vijë të lakuar për të ndjekur rrugën reale ndërmjet dy qyteteve në hartë, p.sh. Tiranë – Vlorë. Ata vendosin spangon mbi rrugën që lidh dy qytetet duke ndjekur kthesat dhe drejtimin real të saj. Më pas, nxënësit e vendosin spangon pranë vizores dhe matin gjatësinë e saj. P.sh., gjatësia e rrugës në hartë del 8 cm.

Nëse harta ka shkallën 1: 1 000 000, atëherë: 1 cm në hartë = 10 km në terren. Nxënësit kryejnë llogaritjen: 8 cm × 10 km = 80 km.

Pra, ata përfundojnë se largësia rrugore ndërmjet Tiranës dhe Vlorës është rreth 80 km.

Në vijim, nxënësit krahasojnë rezultatin me largësinë në vijë ajrore dhe evidentojnë se rruga reale është më e gjatë, sepse ndjek relievin, kthesat, zonat e banuara dhe infrastrukturën rrugore.

Gjatë diskutimit, nxënësit analizojnë:

- Pse rrugët nuk ndërtohen gjithmonë në vijë të drejtë?
- Si ndikojnë malet, lumenjtë apo qytetet në gjatësinë e rrugëve?
- Në cilat situata përdoret largësia rrugore në jetën reale?

Përmes matjes, krahasimit dhe interpretimit të të dhënave, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të përdorur shkallën e hartës dhe për të kuptuar ndryshimin ndërmjet largësisë në vijë ajrore dhe largësisë rrugore.

Çdo grup paraqet rezultatet e punës në një tabelë krahasuese dhe shpjegon mënyrën si i ka llogaritur largësitë.

Nxënësit krahasojnë largësinë në vijë ajrore me largësinë rrugore dhe diskutojnë faktorët që ndikojnë në ndryshimin e tyre.

Çdo grup paraqet rezultatet në një tabelë krahasuese:

Qytetet	**Distanca në hartë**	**Distanca reale në vijë ajrore**	**Distanca rrugore**	**Cila është më e madhe?**	**Pse ndryshojnë distancat?**
Tiranë – Vlorë					

Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve. Mësuesi nxit diskutimin me pyetje si:

- Pse avionët ndjekin rrugë më të drejta se makinat?
- Si ndikon relievi në ndërtimin e rrugëve?
- Pse hartat me shkallë të ndryshme japin nivele të ndryshme hollësie?
- Në cilat raste na duhet të dimë largësinë reale?

	Në përfundim, nxënësit analizojnë situata konkrete ku përdoren matjet e largësive, si planifikimi i udhëtimeve, lundrimi në aplikacione digjitale, transporti dhe logjistika; shërbimet e emergjencës. Përmes matjes, llogaritjes, krahasimit dhe interpretimit të të dhënave, nxënësit zhvillojnë aftësinë për të përdorur shkallën e hartës në situata reale, për të kuptuar marrëdhënien ndërmjet distancës në hartë dhe largësisë reale në terren, si dhe për të shpjeguar ndryshimet ndërmjet largësisë në vijë ajrore dhe largësisë rrugore.

Tabela 3. Shembuj të veprimtarive për përmbushjen e RN-ve në nëntematikën "Mjedisi ynë lokal"

Rezultat i të nxënit	***Veprimtari praktike***
Nxënësi demonstron orientimin në terren duke përdorur elementet natyrore, si Diellin, myshqet në pemë, rrathët e drurëve të pemëve etj., për të përcaktuar drejtimet kryesore të horizontit në mjedisin lokal.	***Veprimtaria rekomandohet të zhvillohet në oborrin e shkollës ose në një hapësirë të hapur (si, p.sh., park).*** ***Situata e të nxënit.*** Mësuesi paraqet skenarin: Një grup eksploruesish gjatë një ecje në natyrë humbet kontaktin me guidën. Telefonat nuk punojnë dhe grupi duhet të gjejë drejtimin për t'u kthyer në pikën e nisjes duke përdorur vetëm shenjat e natyrës. Nxënësit ndahen në ekipe "eksploruesish" dhe secili grup plotëson një tabelë vëzhgimi. Çdo ekip duhet të përfundojë disa sfida orientimi. ***Veprimet në situatë /Zgjidhja e problemit.*** ***Sfida 1: Gjej Veriun*** Nxënësit dalin në oborr dhe përdorin hijen e një shkopi për të përcaktuar drejtimet kryesore. Për të gjetur drejtimet saktë, nxënësit duhet të ndjekin këto hapa: • ***Hapi 1: Vendosja e shkopit dhe shënimi i hijes së parë.*** Nxënësit vendosin një shkop vertikalisht në tokë dhe shënojnë me një gur majën e hijes së parë. Kjo pikë (A) tregon Perëndimin (P).

	• ***Hapi 2: Pritja dhe zhvendosja e hijes.*** Nxënësit presin rreth 15–20 minuta dhe vëzhgojnë si ndryshon pozicioni i hijes për shkak të lëvizjes së dukshme të Diellit. • ***Hapi 3: Shënimi i hijes së dytë dhe krijimi i vijës Lindje–Perëndim.*** Nxënësit shënojnë majën e hijes së re me një gur tjetër (Pika B). Më pas bashkojnë dy pikat me një vijë të drejtë për të krijuar boshtin Lindje–Perëndim. • ***Hapi 4: Përcaktimi i Veriut dhe Jugut.*** Nxënësit vendosen me këmbën e majtë te pika e parë (Perëndimi) dhe këmbën e djathtë te pika e dytë (Lindja). Në këtë pozicion përballë tyre është Veriu (V); pas shpine është Jugu (J). 

	Mësuesi nxit diskutimin përmes pyetjeve: Pse hija lëviz? Pse kjo metodë funksionon vetëm gjatë ditës? Ekipi fiton pikë nëse arrin të orientohet saktë. ***Sfida 2: Detektivët e natyrës*** Çdo ekip eksploron zonën përreth shkollës ose parkut dhe vëzhgon elemente natyrore që mund të ndihmojnë për orientim. Nxënësit kërkojnë: • pemë me myshqe dhe evidentojnë në cilën anë të trungut janë më të zhvilluara; • zona më të lagështa dhe më pak të ndriçuara; • degë pemësh më të zhvilluara në anën me më shumë dritë; • pozicionin e Diellit dhe drejtimin e hijes. Nxënësit mbajnë shënime në tabelën e vëzhgimit dhe diskutojnë si këto elemente mund të përdoren për të përcaktuar drejtimet kryesore të horizontit. Ndërkohë që vëzhgojnë, nxënësit plotësojnë në tabelë:

Shenja natyrore	Çfarë vumë re?	Çfarë drejtimi mund të tregojë?
P.sh., Myshku në pemë	Më i dendur në një anë të trungut	Zakonisht tregon anën veriore ose më pak të ndriçuar

Më pas ekipet diskutojnë:

- A janë gjithmonë të sakta këto shenja?
- Pse duhet të përdorim më shumë se një tregues?

Sfida 3: Gjej rrugën

Mësuesi vendos disa pika orientimi në oborr ose park: p.sh., një pemë, një stol, një tabelë etj.

Ekipet marrin udhëzime, si p.sh.:

- "Lëviz 20 hapa drejt Lindjes";
- "Kthehu drejt Veriut deri te pema";
- "Vazhdo drejt Perëndimit deri te stoli".

Nxënësit duhet të arrijnë në "pikën finale" duke përdorur:

- drejtimet kryesore;
- Diellin;
- objektet orientuese.

Pas sfidave, nxënësit diskutojnë:

- Cila metodë orientimi ishte më e besueshme?
- Pse njerëzit përdornin natyrën për orientim në të kaluarën?
- A do të mund të orientoheshim sot pa teknologji?

	Reflektimi dhe lidhja me jetën reale. Nxënësit lidhin veprimtarinë me situata reale, si ecjet në natyrë, kampingjet, udhëtimet në male, situatat emergjente, eksplorimet. Ata arrijnë në përfundimin se orientimi është një aftësi praktike që ndihmon njerëzit të lëvizin në mënyrë të sigurt dhe të kuptojnë më mirë hapësirën që i rrethon.
Rezultat i të nxënit	***Veprimtari praktike***
Nxënësi përshkruan strukturën moshore të popullsisë në zonën ku jeton, duke dalluar grupmoshat që dominojnë.	***Situata e të nxënit.*** Mësuesi paraqet fotografi nga qyteti ose fshati ku jetojnë nxënësit: • një kënd lojërash me fëmijë; • një qendër sportive me të rinj; • një park ose shesh ku ndodhen të moshuar. Nxënësit vëzhgojnë figurat dhe diskutojnë: • Cilët njerëz shohim më shpesh në qytetin/fshatin tonë? • A ka më shumë fëmijë, të rinj apo të moshuar? • Si ndryshojnë nevojat e tyre? Mësuesi shpjegon me gjuhë të thjeshtë se në çdo qytet ose fshat jetojnë njerëz të moshave të ndryshme. Disa zona kanë më shumë fëmijë, disa më shumë të rinj, ndërsa në disa zona jetojnë më shumë të moshuar. Mënyra si shpërndahen njerëzit sipas moshës quhet strukturë moshore e popullsisë. Më pas prezanton grupmoshat kryesore: • fëmijë (0–14 vjeç); • të rinj (15–29 vjeç); • të rritur (30–64 vjeç); • të moshuar (65+ vjeç).

Veprimet në situatë /Zgjidhja e problemit. Nxënësit punojnë në grupe dhe marrin një tabelë me të dhëna të thjeshta për popullsinë e qytetit ose fshatit ku jetojnë (ose të dhëna të përgatitura nga mësuesi).

P.sh.:

Grupmosha	Numri i banorëve
0–14 vjeç	1200
15–29 vjeç	1800
30–64 vjeç	3200
65+ vjeç	900

Nxënësit:

1. lexojnë tabelën;
2. krahasojnë grupmoshat;
3. evidentojnë grupmoshën që ka numrin më të madh të banorëve;
4. diskutojnë çfarë tregon kjo për qytetin ose fshatin ku jetojnë.

Mësuesi i ndihmon me pyetje, si: Cila grupmoshë është më e madhe? Çfarë mund të kuptojmë nga këto të dhëna?

Nxënësit ndërtojnë një grafik të thjeshtë me ngjyra të ndryshme për secilën grupmoshë. Ata analizojnë cila shtyllë është më e lartë; cila grupmoshë dominon; çfarë nevojash mund të ketë komuniteti i tyre.

Mësuesi drejton diskutimin:

- Nëse ka shumë fëmijë, çfarë i duhet më shumë qytetit/fshatit?
- Nëse ka shumë të moshuar, çfarë shërbimesh nevojiten?

Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve. Nxënësit lidhin strukturën moshore me jetën reale dhe diskutojnë:

	• Pse qytetet me shumë fëmijë kanë nevojë për më shumë shkolla dhe kënde lojërash? • Pse zonat me shumë të moshuar kanë nevojë për më shumë shërbime shëndetësore? • Si ndikojnë grupmoshat në jetën ekonomike dhe shoqërore të komunitetit? Çdo grup propozon një shërbim ose hapësirë që i nevojitet më shumë qytetit/fshatit sipas grupmoshës dominuese. P.sh.: më shumë të rinj → qendra sportive; më shumë fëmijë → kënde lojërash dhe shkolla; më shumë të moshuar → qendra shëndetësore dhe hapësira çlodhëse. Në përfundim, nxënësit reflektojnë: • Çfarë është struktura moshore? • Cilat grupmosha dominojnë në qytetin/fshatin tonë? • Si ndikon struktura moshore në jetën e komunitetit? Përmes klasifikimit, krahasimit dhe interpretimit të të dhënave, nxënësit zhvillojnë kuptimin për strukturën moshore të popullsisë dhe lidhin grupmoshat dominuese me nevojat dhe zhvillimin e qytetit ose fshatit ku jetojnë.
Rezultat i të nxënit	***Veprimtari praktike***
Nxënësi dallon karakteristikat kryesore të vendbanimeve në qytetin/fshatin e tij dhe si ato janë ndikuar nga faktorë të ndryshëm, si faktorët	***Situata e të nxënit.*** Mësuesi paraqet dy pamje: a) një fshat malor me shtëpi të shpërndara; b) një zonë urbane me pallate, rrugë të gjera dhe ndërtesa të shumta. Nxënësit krahasojnë pamjet dhe diskutojnë: • Cilat dallime vërejmë ndërmjet zonës urbane dhe fshatit? • Pse shtëpitë dhe rrugët nuk janë njësoj?

<table>
<tr>
<td>klimatikë, urbanizimi, zhvillimi industrial etj.</td>
<td>

Çfarë mund të ketë ndikuar në zhvillimin e këtyre vendbanimeve?

Mësuesi drejton pyetjen problemore: “Pse vendbanimet ndërtohen dhe zhvillohen ndryshe?”
Veprimet në situatë /Zgjidhja e problemit.
Vëzhgo – Mendo – Shpjego: Nxënësit punojnë individualisht për disa minuta dhe plotësojnë një tabelë vëzhgimi:
<table>
<tr><th>Çfarë vëzhgoj?</th><th>Pse mund të ketë ndodhur kështu?</th></tr>
<tr><td>Pallate të larta në qytet</td><td>Ka më shumë popullsi dhe mungesë hapësire</td></tr>
<tr><td>Shtëpi të shpërndara në fshat</td><td>Ka më shumë tokë dhe aktivitet bujqësor</td></tr>
<tr><td>Rrugë të gjera në qytet</td><td>Lëvizje më e madhe e njerëzve dhe automjeteve</td></tr>
</table>
Më pas nxënësit ndajnë mendimet me klasën dhe argumentojnë përgjigjet e tyre.
Lojë në role: Nxënësit marrin rolin e “reporterëve”. Ata dalin në oborrin e shkollës ose përdorin fotografi të qytetit/fshatit ku jetojnë dhe evidentojnë:

gjelbra; llojin e banesave;
rrugët;

</td>
</tr>
</table>

	▪ hapësirat e bizneset; ▪ ndërtesat industriale; ▪ zonat bujqësore. Çdo nxënës zgjedh një element dhe përpiqet të shpjegojë pse ndodhet aty; si lidhet me klimën, relievin, urbanizimin apo zhvillimin ekonomik. P.sh.: shtëpitë me çati të pjerrëta në zona me reshje, fabrikat pranë rrugëve kryesore, ndërtesat e larta në qytete me popullsi të madhe. ***Simulim "Po të isha urbanist…":*** Mësuesi paraqet skenarin: "Në qytetin/fshatin tuaj do të ndërtohet një lagje e re. Ju jeni urbanistët që duhet të vendosni si do të organizohet." Nxënësit, në dyshe ose grupe të vogla: • vizatojnë një plan të thjeshtë të vendbanimit; • zgjedhin ku do të ndërtohen shtëpitë, rrugët, shkolla apo bizneset; • argumentojnë pse i vendosën në ato vende. Ata duhet të marrin parasysh klimën; relievin; popullsinë; transportin; aktivitetet ekonomike. Nxënësit analizojnë situata reale: • zgjerimin e qyteteve; • ndotjen nga industria; • largimin e popullsisë nga fshatrat; • mungesën e hapësirave të gjelbra. Ata diskutojnë: • Si e ndryshon urbanizimi jetën në qytet? • Cilat janë përparësitë dhe problemet e zhvillimit industrial?

	Mësuesi nxit nxënësit të argumentojnë mendimet e tyre duke përdorur shembuj nga zona ku jetojnë. ***Reflektimi dhe nxjerrja e përfundimeve.*** Në përfundim, nxënësit reflektojnë: • Cilat janë karakteristikat kryesore të qytetit/fshatit tonë? • Cilët faktorë kanë ndikuar më shumë në zhvillimin e tij? • Si mund të ndryshojë vendbanimi ynë në të ardhmen? Përmes vëzhgimit, analizës, argumentimit dhe zgjidhjes së situatave problemore, nxënësit kuptojnë se vendbanimet ndryshojnë sipas kushteve natyrore dhe zhvillimit njerëzor dhe lidhin njohuritë gjeografike me jetën reale dhe mjedisin ku jetojnë.